



Federata e
Hendbollit e
Kosovës

Rregullat e lojës

Edicioni: 1. Korrik 2010



Botues:**FEDERATA E HENDBOLLIT E KOSOVËS**

Shoqata e Gjyqtarëve e Hendbollit të Kosovës

Redaktor:

Izet Gjinovci - Sekretar i përgjithshëm i FHK-së

Pëgatitën:

Fahredin Hashani - Vëzhgues i EHF-it

Afrim Azemi - Gjyqtar i EHF-it

Eshref Beqiri - Gjyqtar i EHF-it

Arsim Vitaku - Gjyqtar i EHF-it

Erdoan Vitaku - Gjyqtar i EHF-it

Sherif Xhema - Kandidat për gjyqtar të EHF-it

Isterf Sadriu - Kryetar i SHGJHK-së

Sedat Zhuri - Sekretar i SHGJHK-së

Realizimi kompjuterik:

Sherif XHEMA

Shtypi:

Grafoprint

Rr. Adrian Krasniqi 16,

10000 Prishtinë, Kosova

Tel:038 223 133

e-mail: grafoprint_67@yahoo.com

Numrat e faqeve

RREGULLA 1 Fusha e lojës

1:1 Fusha e lojës (shih diagramin nr. 1) është me gjatësi 40m dhe gjerësi 20m kënddrejtë, e përbërë prej dy hapësirave të portierit (shih 1:4 dhe 6) dhe fushës për lojë. Vijat gjata të cilat kufizojnë gjatësinë e fushës quhen vijat e autit, ndërsa ato të shkurtat quhen vijat e golautit.

Përreth fushës duhet të ekzistojë zona e sigurisë, e gjerë më së paku 1m përballë vijës së autit dhe 2m pas vijave të gol-autit.

Karakteristikat e fushës nuk guxon të ndryshojë gjatë ndeshjes në të mirë të njëres skuadër.

1:2 Porta (shih diagramin nr. 2a dhe 2b) është e vendosur në mes të secilës vijë të gol-autit. Portat duhet të jenë të fiksuara në vetë sipërfaqen e fushës, ose të jenë të përforcuara në murin që gjendet mbas tyre. Lartësia e brendshme e portës është 2m, ndërsa gjerësia 3m.

Shtyllat e portës janë të lidhura me tërthortën. Skaji i fundit i tërthores duhet të jetë paralel me skajin e fundit të vijës së gol-autit. Shtyllat dhe tërthorësja duhet të jenë në formë katrorë (8cm). Të tri anët që i shohin lojtarët duhet të jenë të ngjyrosura me dy ngjyra të ndryshme, të cilat dallohen njëra prej tjetrës, si dhe me prapavijën.

Në portë duhet të vendoset rrjeta. Ajo duhet të jetë e ngjitur dhe e përforcuar në atë mënyrë sa që topi që ka hyrë në portë në rrethana normale të mbetet aty.

1:3 Të gjitha vijat e fushës janë pjesë përbërëse e zonës të cilën e kufizojnë. Vijat e portës në mes të shtyllave janë të gjera 8cm (shih diagramin 2b) , ndërsa gjerësia e të gjitha vijave tjera në fushë është 5cm.

Dy segmentet e fushës të cilat preken në mes veti mund të ngjyrosen edhe me ngjyra të ndryshme.


- 1:4** Para çdo porte gjendet hapësira e portierit (diagrami nr 5.) Vija e hapësirës së portierit (vija e 6m) kufizon vetë hapësirën e portierit, e cila është e tërhequr si vijon:
- a) Para portës, në largësi prej 6m, por paralel me vijën e portës, tërhiqet vija e gjatë 3m (distanca matet nga buza e pasme e vijës së portës deri te buza e përparme e vijës kufizuese të hapësirës së portierit).
 - b) Dy të katërtat e rrethit me gjysmëhark prej 6m (e matur nga skaji i brendshëm i fundit i shtyllës) lidh vijën e gjatë 3m me vijën e gol-autit (*diagrami nr.1 dhe 2a*)
- 1:5** Vija e gjuajtjes së lirë (vija e nëntëmetërshit) është e ndërprerë dhe tërhiqet paralel me vijën e hapësirës së portierit në distancë prej 3m. Pjesët e ndërprera të vijës së gjuajtjes së lirë, si dhe distancat në mes tyre janë të gjata nga 15cm (*diagrami nr.1*)
- 1:6** Vija e shtatëmetërshit është vijë e drejtë e gjatë 1m. Tërhiqet paralel me vijën e portës në distancë prej 7m. Kjo distancë matet prej skajit të fundit të vijës së portës e deri në skajin e parë të vijës së shtatëmetërshit (*diagrami nr.1*)
- 1:7** Vija kufizuese e portierit (vija 4m) është vijë e gjatë 15cm dhe gjendet para portës. Ajo është e tërhequr paralel me vijën e portës, në distancë prej 4m. Kjo distancë matet prej skajit të fundit të vijës së portës, deri te skaji i parë i vijës kufizuese të portierit (*diagrami. nr. 1*)
- 1:8** Vija e mesit të fushës lidh pikat qendrore të dy vijave të autit (*diagrami nr. 1 dhe nr . 3*).
- 1:9** Vija e hapësirës për zëvendësimin e lojtarëve (pjesa e vijës së autit) përfundon në secilën gjysmë të fushës, 4,5 m nga vija e mesit. Nga kjo pikë e fundit të vijës për zëvendësimin e lojtarëve tërhiqet shenja e gjatë 15cm paralel me vijën e mesit si dhe nga dy anët e vijës së autit (*diagrami nr.1 dhe nr.3*).

Shënim:

Detajet që kanë të bëjnë me kërkesat teknike për fushën e lojës dhe portat janë të paraqitura në faqen 'Udhëzimi - Fusha e lojës dhe portave'



Diagrami 1: Fusha e Lojës

Dimensionet e shënuara në cm




Hapësira e Portierit: shih gjithashtu diagramin 5 (faqe)


Diagrami 2a: Porta



Diagrami 2b: Porta - pamja anësore



Diagrami 3: Vija e zëvendësimeve dhe zona e zëvendësimeve



Tavolina për kohëmatësin dhe procesmbajtësi si dhe bankat për zëvendësimin e lojtarëve duhet të vendosen në atë mënyrë që kohëmatësi/procesmbajtësi mund t'i shohin vijat për zëvendësimin e lojtarëve. Tavolina duhet të vendoset më afër vijës së autit se sa banka për zëvendësimin e lojtarëve dhe atë më së paku 50 cm. Njëherit edhe distanca deri te vija e autit duhet të jetë së paku 50 cm.

Kohëzgjatja e lojës

2:1 Kohëzgjatja normale e lojës për të gjitha ekipet me lojtarë të moshës 16 vjet dhe më të vjetër është 2 pjesë ka 30 minuta. Pushimi në mes të dy pjesëve është 10 minuta.

Kohëzgjatja normale e lojës për grup - moshat e reja 12 – 16 është 2 x 25 minuta dhe 2 x 20 në gurb - moshën 8 – 12. Në të dy rastet pushimi në mes të dy pjesëve është 10 minuta.

2:2 Nëse pas kalimit të kohës së rregullt për lojë rezultati ngel i barabartë e ndeshja duhet të luhet deri në vendimin definitiv, atëherë, pas pushimit prej 5 minuta, luhen vazhdimet. Vazhdimet zgjasin 2 x 5 minuta ndërsa pushimi në mes dy vazhdimeve 1 minuta.

Nëse ndeshja dhe pas këtyre vazhdimeve nuk vendoset, pas pushimit prej 5 minuta, pasojnë vazhdimet plotësuese prej 2 x 5 minuta, me 1 minutë pushim në gjysëmlojë.

Nëse edhe atëherë nuk përcaktohet fituesi, veprohet në bazë të propozicioneve të garave gjegjëse. Në rastë se vendoset për ekzekutimin e 7 – m si shtesë për përcaktimin e fituesit, duhet të përcillen procedurat e shënuara më poshtme.

SHPJEGIMI:

Në qoftë se fituesi duhet të caktohet me ekzekutimin e shtatëmeter-sheve, ekzekutimi i shtatëmeter-sheve i lejohet vetëm atyre lojtarëve të cilët në përfundimin e lojës nuk janë të përjashtuar me 2 min, shkualifikim apo përjashtimi deri në fund. Para se të ekzekutohen 7m, secili ekip duhet ti emërtoj pesë lojtarë, këta lojtarë duhet të ekzekutojnë nga një gjuajtje, duke ja kaluar rendin lojtarëve kundërshtarë. Skuadrat nuk janë të obliguara që para fillimit të ekzekutimit të 7m të bëjnë renditjen e ekzekutuesve. Portieri mund të përzgjidhet lirisht dhe ndërrohet në mes të lojtarëve të cilët kanë të drejt paraqitje në lojë. Lojtarët mund të jenë pjesëmarrës të ekzekutimit të 7m si lojtar apo portier.

Gjyqtarët vendosin se në cilën pjesë të fushës do të bëhet ekzekutimi i 7m. Para fillimit të ekzekutimit të 7m, me hedhjen e monedhës përcaktohet renditja e ekzekutuesve, kurse skuadra e cila e fiton shortin vendos se a do të fillon e para me ekzekutim apo do të ja lenë kundërshtarit. Në qoftë se pas ekzekutimeve të 7m të para rezultati është i barabartë, vazhdon ekzekutimi 7 m, por tani renditja e ekzekutuesve është e kundërt. Në qoftë se vije deri tek vazhdimi i ekzekutimeve të 7m, secila skuadër duhet të nominon nga 5 lojtar ekzekutues. Prapë mund të caktohen të njëjtit ekzekutues apo vetëm ndonjëri nga ekzekutuesit e rrethit të parë. Nominimi (caktimi) i lojtarëve me këtë princip aplikohet deri sa të kemi fituesin e ndeshjes. Mirëpo, në serinë e dytë dhe të gjitha seritë e tjera fituesi vendoset në qoftë se ekziston dallimi (diferenca) në shënime pas ekzekutimit të një numri të caktuar të 7m.

Lojtarët mund të shkualifikohen gjatë ekzekutimit të 7m, në qoftë se kanë sjellje josportive(16.13). Në qoftë se shkualifikimi ka të bëjë me lojtar i cili ka qenë i nominuar (caktuar) në grupin e 5 ekzekutuesve të 7m, skuadra duhet të nominon lojtar tjerë.

Shenja për përfundimin e ndeshjes

2:3 Loja fillon me fishkëllimën e gjyqtarëve për gjuajtjen fillestare nisëse. Përfundon me shenjën automatike për përfundimin e ndeshjes të aparatit publik për matjen e kohës ose me fishkëllimën e kohëmatësit. Nëse nuk ndëgjohet një sinjal i tillë, gjyqtari fishkëllon për të treguar se kohëzgjatja e lojës ka përfunduar (17:9)

SHPJEGIMI:

Nëse nuk ekziston aparati publik për matjen e kohës me sinjal automatik për përfundimin e ndeshjes, kohëmatësi do të matë kohën me ndihmën e orës në tavolinë ose me kronometër, dhe pas kalimit të kohës së paraparë për lojë jep shenjë për përfundimin e ndeshjes (rregulla 18:2 paragrafi 2)

2:4 Ndërhyrja ose sjelljet josportive, të cilat janë bërë para ose gjatë dëgjimit të shenjës për përfundim të gjysëmlojës ose ndeshjes, patjetër sanksionohen, edhe pse kjo mund të bëhet edhe pas dëgjimit të shenjës, gjithashtu duhet sanksionuar edhe nëse kemi gjuajtje të lirë (*sipas rregullës 13:1*) ose ekzekutimin e shtatëmetërshit edhe pse nuk është e mundur të ekzekutohet para dhënien së shenjës mbi përfundimin e ndeshjes.

Njëkohësisht, gjuajtja duhet të korrigjohet, nëse shenja e fundit (për përfundimin e gjysëmlojës apo tërë ndeshjes apo edhe kohës shtesë) dëgjohet saktësisht kur gjuajtja e lirë apo gjuajtja e shtatëmetërshit veç është ekzekutuar apo kur topi tashmë është në ajër.

Në të dy rastet, gjyqtarët përfundojnë ndeshjen vetëm pasi që gjuajtja e lirë apo shtatëmetërshi ekzekutohet dhe epilogu përfundimtar është vendosur.

2:5 Për gjuajtjen e lirë që duhet të ekzekutohet sipas rregullës 2:4, për të dy skuadrat vlen rregull e veçantë në marrjen e pozitës së lojtarëve në fushë dhe lojtarëve që gjenden në hapësirën për ndërrimin e lojtarëve. Si përjashtim mund të jetë në zëvendësimin e lojtarëve rregulla 4:4 dhe i vetmi zëvendësues është lejuar për një lojtarë të skuadrës që ekzekuton gjuajtjen. Cenimi dhe mos respektimi sanksionohet sipas rregullës 4:5 paragrafi 1. Të gjithë bashkë-lojtarët e ekzekutuesit duhet të pozicionohen 3 m larg nga ekzekutuesi, dhe të gjenden jashtë vijës së gjuajtjes së lirë të skuadrës kundërshtare (13:7, 15:6: *shih po ashtu udhëzimin nr.1*). Pozita e lojtarëve mbrojtës është rreguar në rregullën 13:8.

2:6 Në rrethana të cilat janë përshkruar në kuadër të rregullës 2:4 - 5 lojtarëve ose përfaqësuesve të skuadrave mund t'iu shqiptohen ndëshkimet personale për shkak të ndërhyrjes ose sjelljes josportive me rastin e ekzekutimit të gjuajtjes së lirë ose shtatëmetërshit. Cenimi i rregullave me rastin e ekzekutimit të njëres nga gjuajtjet e cekura nuk mund të ketë për pasojë gjuajtjen e lirë për skuadrën kundërshtare.

2:7 Nëse gjyqtarët konstatojnë se kohëmatësi e ka përfunduar para kohë lojën, duke dhënë shenjën për përfundimin e gjysmë lojës ose të ndeshjes, obligohen t'i ndalin lojtarët në fushë dhe të kompensojnë kohën e lojës së mbetur.

Lojën e vazhdon skuadra e cila ka qenë në pronësi të topit para dhënies para kohe të shenjës për përfundimin e gjysmë lojës ose të ndeshjes. Nëse në atë moment loja ka qenë e ndërprerë, ndeshja vazhdon me gjuajtje e cila i përgjigjet situatës së dhënë në fushë, e nëse kjo nuk është e mundshme, ndeshja do të vazhdojë me gjuajtje të lirë, në pajtim me dispozitat e rregullës 13:4a -b.

Nëse gjysmë loja (ose vazhdimi) ka zgjat më tepër, pjesa e dytë duhet të shkurtohet për kohën gjegjëse. Nëse pjesa e dytë e ndeshjes (ose vazhdimi) kryhet me vonesë gjyqtarët këtë më nuk mund ta ndryshojnë.

Time – Out-i

2:8 Time – Out-i është i obliguar në këto raste:

- a) përjashtimi në 2 min, shkualifikimi;
- b) në qoftë se lejohet tajm-out-i ekipor;
- c) dhënia e shenjës me fishkëllimë e kohëmatësit ose e vëzhguesit;
- d) marrëveshja ndërmjet gjyqtarëve, në pajtim me rregullën 17.7

Time-out-i normalisht jepet edhe në disa situata tjera, varësisht nga rrethanat (*shih udhëzimin nr.2*)

Ndërhyrjet gjatë tajm- out-it sanksionohen njësoj, si edhe ato që janë bërë gjatë lojës (16:10).

2:9 Në parim, në lidhje me time-out-in gjyqtarët vendosin se kur duhet ndalur dhe filluar koha. Ndërprerja e lojës i sinjalizohet kohëmatësit me tri fishkëllima të shkurtra me pip dhe me shenjën nr. 15.

Në rastet kur është e obliguar të gjykohet tajm-out-i, dhe shenjë për ndaljen e lojës ka dhënë kohëmatësi ose vëzhguesi (2.8 b-c), kohëmatësi duhet menjëherë të ndal matjes së kohës (semaforin), pa pritur konfirmimin prej gjyqtarëve.

Pas time-out-it gjithmonë duhet t'i bihet pipit për të dhënë shenjë për rifillimin e ndeshjes (15:5b)

SHPJEGIMI:

Shenja elektronike nga tavolina zyrtare nga ana e kohëmatësit apo vëzhguesit automatikisht e ndal matjen e kohës. Edhe në rastet kur gjyqtarët nuk e vërejnë që loja është ndërprerë nga tavolina zyrtare, dhe çdo aksion i mëtejshëm në fushë pas shenjës është e parregullt. Kjo do të thotë që nëse shënohet gol pas shenjës, i njëjti duhet të anulohet. Gjithashtu i parregullt kishte me qenë vendimi për gjykimin e njëres nga gjuajtjet për skuadër (7m, gjuajtje e lirë, nisja nga qendra), loja duhet të vazhdojë me gjuajtje e cila i përgjigjet situatës e cila ka qenë në momentin kur është dhënë shenja për ndërprerjen e lojës nga tavolina zyrtare (duhet pasur në mendje që arsyeja më e shpeshtë e dhënies së shenjës nga tavolina zyrtare është zëvendësimi i gabuar apo tajm-out-i ekipor). Në të kundërtën çdo ndëshkim personal të cilët gjyqtarët e kanë gjykua në kohën në mes të shenjës së dhënë nga tavolina zyrtare dhe momentit kur gjyqtarët kanë dhënë shenjë për ndërprerje të lojës mbetët i plotfuqishëm. Kjo aplikohet pa marrë parasysh për llojin e ndërhyrjes së palejuar dhe pa marrë parasysh peshën e ndëshkimit të shqiptuar.

2:10 Gjatë gjysmë lojës të kohës së rregullt për lojë, çdo skuadër ka të drejtë nga një tajm-aut ekipor në kohëzgjatje prej 1 minute (shih udhëzimin nr.3)

RREGULLA 3 Topi

3:1 Topi përbëhet nga lëkura ose materiali artificial. Topi duhet të jetë i rrumbullakët. Materiali i jashtëm nuk guxon të jetë i shndritshëm dhe i rrëshqitshëm (17:3)

3:2 Disa kategori të lojtarëve duhet t'i shfrytëzojnë topat e këtyre madhësive gjegjësisht perimetrit dhe peshës:

- 58-60cm dhe 425-475g (madhësia 3 e IHF) për Seniorë dhe meshkuj (mbi 16 vjet)
- 54-56cm dhe 325-375g (madhësia 2 e IHF) për Femra, vasha (mbi 14 vjet), dhe meshkuj (12-16 vjet)
- 50-52cm dhe 290-330g (madhësia 1 e IHF) për vasha (8-14 vjet) dhe meshkuj (8-12 vjet).

SHPJEGIMI:

Dispozitat e IHF -it, në lidhje me topat për lojë, përmbajnë të gjitha kërkesat teknike të topave që shfrytëzohen në të gjitha ndeshjet zyrtare ndërkombëtare.

Këto rregulla nuk përmbajnë dispozitat në lidhje me madhësinë dhe peshën e topave që shfrytëzohen për "mini hendboll".

3:3 Në çdo ndeshje duhet të përgatiten së paku dy topa. Topat rezervë duhet të qëndrojnë në tavolinën e procesmbajtësit dhe të jenë në dispozicion në çdo moment. Topat duhet t'u përgjigjen dispozitave të rregullës 3:1 - 2.

3:4 Gjyqtarët vendosin se kur do të shfrytëzohet topi rezervë. Në atë rast është e domosdoshme që topi të jetë sa ma parë në dispozicion dhe ndërprerja të zgjasë më shkurtë, si dhe të evitohet nevoja për dhënien e time-out-it.

Skuadra**4:1** Skuadrën e përbëjnë më së shumti 14 lojtarë.

Në fushë, njëkohësisht, guxojnë të gjenden më së shumti 7 lojtarë të njëres skuadër. Lojtarët tjerë janë lojtarë rezervë.

Gjatë gjithë kohëzgjatjes së ndeshjes, skuadra një lojtarë në fushë të identifikuar si portier. Lojtari i cili është i identifikuar si portier në çdo moment mundë të paraqitet ti lojtarë në fushë (*shih, megjithatë, Rregullën 8:5 shpjegimin, paragrafin 2*). Gjithashtu, secili lojtar në fushë në çdo moment mundë të paraqitet si portier (*shih, megjithatë, 4:4 dhe 4:7*).

Në fillim të ndeshjes, skuadra duhet ti ketë së paku 5 lojtarë në fushë

Numri i lojtarëve të skuadrës mundë të rritet deri në 14 në çdo kohë përfshirë edhe lojën shtesë (vazhdimet)

Loja mundë të vazhdohet edhe nëse ekipi është reduktuar në më pakë se 5 lojtarë në fushë. Është në kompetencë të gjyqtarëve që të vendosin nëse dhe kur duhet që deri në fund të ndërpritet ndeshja (17:12).

4:2 Një skuadër gjatë ndeshjes mund t'i ketë më së tepërmi katër persona zyrtarë. Këta persona gjatë ndeshjes nuk mund të ndërrohen. Njëri prej tyre në procesverbal shënohet si "përfaqësues zyrtar i skuadrës". Vetëm ai ka të drejtë t'i drejtohet kohëmatësit/procesmbajtësit ose eventualisht gjyqtarëve (*shih, megjithatë, Udhëzimit nr.3: time-out-i ekipor*).

Në përgjithësi, përfaqësuesi i skuadrës nuk ka të drejtë që gjatë ndeshjes të futet në fushë. Cenimi i kësaj rregulle sanksionohet si sjellje jospportive (*shih 8:7, 16:1b, 16:3d dhe 16:6c*). Ndeshja në këto raste vazhdohet me gjuajtje të lirë të skuadrës kundërshtare (13:1a-b: *shih, megjithatë, Udhëzimin nr. 7*).

Pasi që loja të fillon, 'përfaqësuesi zyrtarë' i ekipit duhet të siguroj që asnjë person tjetër pos personave zyrtarë (maksimum 4) dhe lojtarëve të regjistruar në procesverbalin e ndeshjes (shih 4:3) nuk guxon të jetë prezent në hapësirën për zëvendësimin e lojtarëve. Cenimi i kësaj rregulle ka për pasojë ndëshkimin progresiv për 'përfaqësuesin zyrtarë të ekipit' (16:1b, 16:3c, dhe 16:6c).

4:3 Lojtari/zyrtarit të ekipit i lejohet të marrë pjesë në lojë nëse është pranishëm në fillim të ndeshjes, dhe është i shënuar në procesverbalin e ndeshjes.

Lojtarët, respektivisht përfaqësuesit e skuadrës që arrin mbas filimit të ndeshjes, duhet të marrin leje nga kohëmatësi/procesmbajtësi për pjesëmarrjen në lojë edhe të jenë të shënuar në procesverbal.

Lojtari që ka të drejtë loje mund të hyjë në çdo moment në lojë, duke shfrytëzuar hapësirën e cila është e paraparë për zëvendësimin e lojtarëve (shih, megjithatë, 4:4 dhe 4:6)

Përfaqësuesi zyrtarë i skuadrës duhet të siguroj që vetëm lojtarët me të drejtë pjesëmarrjeje në lojë të hynë në fushë. Cenimi i kësaj rregulle duhet ndëshkohet si sjellje jo sportive nga përfaqësuesi zyrtar i ekipit (13:1a-b, 16:1-b, 16:3d dhe 16:6c; shih, megjithatë, udhëzimin nr. 7).

Zëvendësimi i Lojtarëve

4:4 Zëvendësuesi mundë të futet në fushë, në çdo moment dhe në mënyrë të përsëritur (*shih, megjithatë, Rregullën 2:5*), pa e paralajmëruar kohëmatësin/procesmbajtësin, për deri sa lojtarin të cilin e zëvendëson e ka lëshuar fushën (4:5).

Lojtarët të cilët marrin pjesë në zëvendësim ju lejohet të zëvendësohen vetëm përmes zonë së zëvendësimit të lojtarëve të gjysmëfushës së vet (4:5). Kjo rregull aplikohet edhe te zëvendësimi i portierëve (*shih gjithashtu 4:7 dhe 14:10*).

Rregulla e zëvendësimit aplikohet gjithashtu edhe gjatë time-out-it (me përjashtim të time-out-it ekipor)

SHPJEGIMI:

Koncepti "vija e zëvendësimit të lojtarëve" siguron zëvendësimin dhe zëvendësimin korrekt të lojtarëve. Qëllimi nuk është të vije deri tek ndëshkimi i lojtarëve në rastet tjera kur lojtari hyn në fushë apo shkel vijën e anësore ose fundore pa qëllim të përfitimit të përparësisë apo të rrezikon kundërshtarin (p.sh. kur shërbehet me ujë të pijshëm apo peshqirin për fshirjen e djersës afër vijës së për zëvendësimin e lojtarëve, apo pasi të gjykimit të ndëshkimit progresiv në mënyrë të qetë e lëshon fushën përmes vijës anësore shumë afër vijës "15cm"). Shfrytëzimi i gabuar i hapësirës për tej hapësirës për zëvendësimin e lojtarëve për qëllime taktike në mënyrë të posaçme është sqaruar në rregullën 7.10.

4:5 Zëvendësimi i gabueshëm i lojtarit ndëshkohet me përjashtim prej 2 minuta të lojtarit që ka gabuar. Nëse në ndonjë situatë të caktuar një numër i madh i lojtarëve të një skuadre bën zëvendësimin e gabueshëm, me përjashtim ndëshkohet vetëm lojtari i parë që ka hyr gabimisht në fushë.

Ndeshja në këtë rast vazhdon me gjuajtje të lirë për skuadrën kundërshtare (Rregulla 13:1a-b, *shih, megjithatë Udhëzimi nr. 7*).

4:6 Nëse në fushë pa zëvendësim futet një lojtarë shtesë, apo në mënyrë të palejuar ndërhyjnë me lojën nga hapësira për zëvendësim, ai duhet të ndëshkohet me 2-minuta përjashtim. Ekipi duhet të reduktohet për një lojtarë në fushë për 2 minutat e ardhshme (pa marrë parasysh faktin se lojtari shtesë që ka hyrë në fushë duhet të largohet nga fusha).

Nëse lojtari i përjashtuar me 2 minuta, gjatë kohëzgjatjes së dënimit hynë në fushë, ai do të përjashtohet edhe me 2 minuta shtesë dhe se matja e kohës fillon menjëherë, kështu që ekipi duhet prapë të reduktohet në fushë për kohën e mbetur në mes të dënimit të parë edhe të dytë.

Në të dy rastet loja fillon me gjuajtje të lirë për skuadrën kundërshtare (13:1a-b; shih, megjithatë, Udhëzimin Nr. 7).

Pajisjet

4:7 Të gjithë lojtarët në fushë të një skuadre duhet veshin uniformë të njëjtë. Kombinimi i ngjyrave dhe dizajni i të dy ekipeve duhet të ketë dallim të qartë nga njëra - tjetra. Lojtarët në pozitën e portierit duhet të veshin ngjyrën e njëjtë, ngjyrë e cila i dallon ata nga lojtarët në fushë të të dy skuadrave dhe nga portierët e skuadrës kundërshtare (17:3).

4:8 Lojtarët duhen që në fanellat e tyre të bartin numra të qartë të madhësisë së paku 20 cm në shpinë dhe së paku 10 cm në gjoks. Numrat duhet të jenë prej 1 deri në 99. Lojtari i cili nga pozita lojtarë në fushë i cili paraqitet si portier në portë duhet të ketë numër të njëjtë në të dy pozitat.

Ngjyra e numrave duhet të dallojë qartë me ngjyrën dhe dizajnin e fanellës.

4:9 Lojtarët duhet të mbathin këpucë sportive.

Nuk është e lejuar veshja, mbathja apo bartja e objekteve të cilat janë të rrezikshme për lojtarin. Kjo përfshinë, ora, unazat, bizhuteri të dukshme në pjesë të shpuara të trupit, qafore ose

zinxhirë, vath, syze pa mbajtës apo me kornizë të fortë, ose çdo objekt tjetër i cili mundë të jetë i rrezikshëm (17:3).

Lojtarët të cilët nuk e përmbushin këtë kërkesë nuk do të lejohen të marrin pjesë në lojë derisa të mos korrigjojnë problemin.

Unazat e rrafshëta, vath të vegjël apo bizhuteri nëpër pjesë të shpuara të trupit, mundë të lejohen, për deri sa janë të mbuluar në atë mënyrë që nuk paraqesin rrezik për lojtarët. Shiriti i kokës, mbulesa e kokës dhe emblema e krahut e kapitenit janë të lejuara përderisa është i punuar nga materiali i butë, elastik.

Lëndimi i Lojtarit

4:10 Lojtari nga i cili rrjedh gjak ose ka gjak në trup ose uniformë duhet ta lëshoj menjëherë dhe vullnetarisht fushën e lojës (përmes vijës për zëvendësim të rregullt), për arsye të ndërprerjes së gjakderdhjes, mbulimin e plagës, dhe pastrimin e trupit dhe uniformës. Lojtari nuk duhet të kthehet në fushë për deri sa të mos jenë kryer këto.

Lojtari i cili nuk ndjek udhëzimet e gjyqtarëve në lidhje me dispozitën e mësipërme konsiderohet fajtorë për sjellje jospportive (8:7, 16:1b dhe 16:3d)

4:11 Në rast të lëndimit, gjyqtarët mundë të japin leje (përmes sinjalit me dorë Nr. 15 dhe 16) për futjen në fushë gjatë time – out-it për dy persona të cilët kanë të drejtë të marrin pjesë (shih 4:3), për qëllime specifike për të ndihmuar lojtarin e lënduar të ekipit të tyre.

Në qoftë se pas dy personave të cilëve u është lejuar hyrja në fushë, hyn edhe dikush tjetër do të i shqiptohet dënimi sikurse të ishte bërë ndërrim i gabuar, në qoftë se bëhet fjalë për lojtarin në përputhje të rregullës 4:6 dhe 16:3a, e nëse bëhet fjalë për përfaqësuesin zyrtarë të skuadrës në përputhje me rregullën 4:2, 16:1b, 16:3d dhe 16:6c. Personit të cilit i është lejuar hyrja në fushë Rregulla 4:11, paragrafi 1, por në vend se të ofroj ndihmë lojtarit të lënduar jep këshilla lojtarëve tjerë, i drejtohet lojtarit kundërshtarë apo gjyqtarëve etj., konsiderohet si fajtorë për sjellje jospportive (sipas rregullave 16:1b, 16:3d dhe 16:6c).

Portierit i lejohet të:

5:1 prek topin me të gjitha pjesët e trupit gjatë aktit të mbrojtjes brenda hapësirës së portierit

5:2 lëvizë me top në hapësirën e portierit, pa qenë subjekt i kufizimeve të aplikuara për lojtarët në fushë (7:2-4; 7:7); megjithatë, portierit nuk i lejohet të vonoj ekzekutimin e gjuajtjes së portierit (6:4-5; 12:2 dhe 15:5b);

5:3 lëshon hapësirën e portierit pa top, dhe të marrë pjesë në lojë në fushën e lojës; kur vepron kështu, portieri bëhet subjekt i rregullave të lojës të cilat aplikohen në fushën e lojës (përveç në situatën e përshkruar në Rregullën 8:5 shpjegimi, paragrafi 2);

Portieri konsiderohet se ka lëshuar hapësirën e ti në atë moment kur ndonjë pjesë e trupit të ti të prek dyshtemenë jashtë vijës kufizuese të hapësirës së tij.

5:4 lëshon hapësirën e portierit me top të cilin nuk e ka nën kontroll edhe të luaj përsëri me të në fushën e lojës.

Portierit nuk i lejohet të:

5:5 rezikon lojtarin kundërshtarë gjatë aktit të mbrojtjes (8:3, 8:5, 8:5 shpjegimi, 13:1b);

5:6 lëshon hapësirën e portierit me top të cilin e ka nën kontroll; kjo çon deri te gjuajtja e lirë (sipas 6:1, 13:1a dhe 15:7, paragrafi 3), nëse gjyqtarët kanë fiskëlluar për ekzekutimin e gjuajtjes së portierit; në të kundërtën gjuajtja e portierit është thjeshtë përsëritje (15:7, paragrafi 2); shih, megjithatë, interpretimin e përparësisë në 15:7, nëse portieri ka kaluar vijën kufizuese të hapësirës së portierit me top në dorë do ta humbas topin;

5:7 prekë topin i cili qëndron apo rrokulliset në dyshteme jashtë hapësirës së portierit, ndërsa ai qëndron në hapësirën e portierit (6:1, 13:1a);

- 5:8** ktthej topin brenda në hapësirën e portierit kur ai qëndron apo rrokulliset në dysHEME jashtë hapësirës së portierit (6:1, 13:1a);
- 5:9** ktthehet në hapësirën e portierit me top nga fusha e lojës (6:1, 13:1a);
- 5:10** prekë topin me shputë apo këmbë nën gju, gjatë lëvizjes në drejtim të fushës (13:1a);
- 5:11** cenon vijën kufizuese të portier (vijën 4m) apo vazhdimin e paramenduar të saj nga të dyja anët për derisa topi mos të lëshojë dorën e lojtarit që ekzekuton 7 m. (14:9).

SHPJEGIMI:

Përderisa portieri qëndron me një rrë shputë në vijën kufizuese për portier (vija 4 m) i lejohet që shputa tjetër ose cilado pjesë tjetër e trupit të lëvizë në ajër përtej asaj vije.

RREGULLA 6 Hapësira e Portierit

6:1 Vetëm portieri mundë të futet në hapësirën e portës (*shih, megjithatë, 6:3*). Hapësira e portës, e cila përfshirë vijën ku-fizuese të hapësirës së portës, konsiderohet hyrje kur lojtari fushës me cilëndo pjesë të trupit e prekë atë.

6:2 Kur lojtari i fushës hyn në hapësirën e portës, vendimi duhet të jetë si në vijim:

- a) kur lojtari i ekipit në posedim të topit futet në hapësirën e portierit me apo pa posedimin e topit dhe me këtë veprim krijon përparësi (12:1);
- b) gjuajtje e lirë nëse ekipi mbrojtës futet në hapësirën e portierit dhe me këtë krijon përparësi, por pa e prishur situatën e qartë për shënim (13:1b; *shih gjithashtu 8:7f*);
- c) 7-m nëse lojtari i ekipit mbrojtës nga fusha futet në hapësirën e portierit dhe për shkak të kësaj prish situatën e qartë për shënim (14:1a). Për qëllimin e kësaj rregulle, koncepti "hyrja në hapësirën e portierit" nuk nënkupton vetëm prekjen e vijës së hapësirës së portierit, por hap (hyrje) e qartë në hapësirën e portierit.

6:3 Hyrja në hapësirën e portierit nuk ndëshkohet kur:

- a) lojtari hyn në hapësirën e portierit pasi të ketë luajtur me top, me kusht që të mos krijoj disavantazh për kundërshtarin;
- b) lojtari i njëres nga ekipet pa top futet hapësirën e portierit dhe duke vepruar kështu nuk krijon përparësi;

6:4 Topi konsiderohet "jashtë lojës" kur portieri brenda hapësirës së portierit kontrollon topin (12:1). Topi duhet të kthehet në lojë përmes gjuajtjes së portierit (12:2).

6:5 Topi mbetet në lojë, nëse është duke u rrokullisur në hapësirën e portierit. Është në posedim të skuadrës së portierit dhe vetëm portieri mundë ta prek atë. Portieri mundë ta kapë, me që rast është jashtë lojë, dhe e kthen atë në lojë, në përputhje me Rregullën 6:4 dhe 12:1-2 (*shih, megjithatë, 6:7b*). Gjuajtje e lirë (13:1a) nëse topi preket nga bashkë lojtari i portierit gjatë

rrokullisjes së topit në hapësirën e portierit (*shih, megjithatë, 14:1a, në ndërthurje me udhëzimin 6c*), dhe loja vazhdon me gjuajtje të portierit (12:1 (III) nëse topi preket nga kundërshtari.

Topi është jashtë lojës, për deri sa qëndron në dysheme në hapësirën e portierit (12:1 (II)). Është në pronësi të skuadrës së portierit dhe vetëm portieri mundë ta prekë atë. Portieri duhet ta kthej atë në lojë në përputhje me 6:4 dhe 12:2 (*shih, megjithatë, 6:7b*), mbetet gjuajtje e portierit nëse topi preket nga çdo lojtarë i secilit ekip (12:1 paragrafi 2, 13:3).

Lejohet prekja e topit kur ai qëndron në ajër mbi hapësirën e portierit, për deri sa është në përputhje me Rregullën 7:1 dhe 7:8.

6:6 Loja duhet të vazhdoj (përmes gjuajtjes së portierit sipas 6:4-5) nëse lojtari i ekipit mbrojtës në aktin e mbrojtjes e prek topin, dhe topi kapet nga portieri apo ndalet në zonën e portierit.

6:7 Nëse lojtari luan me top në hapësirën e tij të portierit, vendimi duhet të jetë si në vazhdim:

- a) gol, nëse topi futet në portë;
- b) gjuajtje e lirë nëse topi ndalet (mbetet) në hapësirën e portierit, nëse portieri e prek topin dhe nuk futet në portë (13:1a-b);
- c) gjuajtje e portierit nëse topi kalon përtej vijës së gol-aut-it (11:1);
- d) loja vazhdon nëse topi kthehet nga hapësira e portierit në fushën e lojës pa e prekur portieri.

6:8 Topi i cili kthehet nga hapësira e portierit në fushën e lojës konsiderohet në lojë.

RREGULLA 7 Loja me Top, Loja Pasive

Loja me Top

Lejohet:

- 7:1** Gjuajtja, kapja, shtyrja, goditja e topit, duke përdorur duart (të hapura ose të mbyllura), krahët, kokën, trungun, kofshët dhe gjunjët;
- 7:2** Mbajtja e topit për maksimum 3 sekonda, edhe në rast kur topi gjendet në dysHEME (13:1a);
- 7:3** Për të bërë maksimum 3 hapa me top (13:1a); një hapë konsiderohet si në vijim:
- a) nëse lojtari, i cili qëndron me të dy këmbët në dysHEME, e ngrit dhe e lëshon këmbën, ose e lëviz këmbën prej një vendi në tjetër;
 - b) lojtari i cili prek dysHEMENË vetëm me një këmbë dhe, kap topin dhe pastaj prek dysHEMENË me këmbën tjetër;
 - c) pas kërcimit lojtari prek dysHEMENË me një këmbë vetëm, dhe pastaj kërcen me të njëjtën këmbë ose prek dysHEMENË me këmbën tjetër;
 - d) lojtari pas kërcimit prek dysHEMENË me të dy këmbët njëkohësisht, edhe pastaj ngritë njërën këmbë dhe e lëshon poshtë përsëri, ose lëvizë njërën këmbë nga një vend në tjetrin.

SHPJEGIMI:

Është në përputhje me rregullat, nëse lojtari me top rrëzohet në dysHEME, rrëshqet dhe ngitet përsëri dhe luan me top. Kjo gjithashtu është si në rastin kur lojtari lufton (rrëshqet me trup) për top, kontrollon atë dhe ngitet për të luajtur.

7:4 Gjatë qëndrimit ose vrapimit:

- a) e udhëheqë topin njëherë dhe e kapë atë përsëri me një dorë apo me dy duart;
- b) e udhëheqë topin vazhdimisht me një dorë (driblon), dhe pastaj e kapë atë përsëri me një dorë apo me dy duart;
- c) e rrokullis topin në dysHEME vazhdimisht me një dorë, dhe pastaj e kapë atë me një apo me të dy duart.

Pasi që topi të kapët me një apo me të dy duart, duhet të luhet më të brenda 3 sekondave apo jo më shumë se 3 hapa (13:1a).

Udhëheqja apo driblimi konsiderohet që ka filluar kur lojtari të ketë prekur topin me ndonjë pjesë të trupit dhe e drejton atë kah dysHEMEJA.

Pasi që topi të ketë prekur ndonjë lojtarë apo portën, lojtarit i lejohet ta udhëheqë apo ta kapë përsëri topin (shih, megjithatë, 14:6).

7:5 Ta lëvizë topin nga një dorë në dorën tjetër;

7:6 Të luaj me top gjunjat, ulur ose i shtrirë në dysHEME; kjo do të thotë se është e lejuar të ekzekutohet gjuajtja (për shembull gjuajtja e lirë), nga këto pozita, nëse kërkesat e Rregullës 15:1 janë plotësuar, përfshirë këtu kërkesën për të pasur një pjesë të njëres këmbë konstant në kontakt me dysHEMENË.

Nuk lejohet:

7:7 Prekja disa herë e topit të arritur nën kontroll para se ai ta prekë dysHEMENË, lojtarin tjetër, ose portën në kuptim të (13:1a), megjithatë, prekja më shumë se disa herë e topit nuk ndëshkohet, nëse lojtari “gabon në lojën” me top, p.sh. dështon ta kontrollojë topin gjatë tentimit për ta kapur apo ndalur atë;

7:8 Prekja e topit me shputë apo me këmbë nën gju, me përjashtim kur lojtari është goditur me top nga kundërshtari (13:1a-b; shih gjithashtu 8:7e);

7:9 Loja vazhdon nëse topi ka prekur gjyqtarin në fushë.

7:10 Nëse lojtari me top lëviz jashtë hapësirës së fushës me një apo me dy këmbët (ndërsa topi akoma gjendet në fushë), me qëllim që të i shmanget lojtarit të mbrojtjes, këtu duhet gjykuar gjuajtje të lirë për kundërshtarin (13:1a).

Nëse lojtari i skuadrës e cila është në posedim të topit me qëllim del jashtë fushës së lojës, gjyqtarët janë të obliguar ta paralajmërojnë lojtarin që të kthehet (hyn) në fushë. Nëse lojtari këtë nuk vepron kështu apo më vonë e përsërit aksionin e tillë, duhet të gjykohet gjuajtje e lirë për kundërshtarin (13.1a) pa i dhënë vërejtje të sërishme. Thyerje të tilla të rregullave nuk kanë për pasoja të gjyimit të ndëshkimit personal sipas Rregullës 8 dhe 16.

Loja Pasive

7:11 mbajtja e topit në pronësi pa qëllim të dukshëm për tu rrezikuar porta e skuadrës kundërshtare respektivisht të gjuajtjes në portë. Gjithashtu kjo vlen edhe për rastet e përsëritura të zvarritjes së lojës, ekzekutimit të gjuajtjes nismëse, gjuajtjes së lirë, rivënies nga ana e skuadrës e cila është në pronësi të topit (*shih Shpjegimin nr. 4*). Kjo konsiderohet lojë pasive e cila sanksionohet me gjuajtjen e lirë kundër skuadrës e cila ka qenë në pronësi të topit (13:1a).

Gjuajta e lirë ekzekutohet nga vendi në të cilin gjendet topi në momentin e ndërprerjes së lojës.

7:12 Nëse vërehet tendenca kah loja pasive, gjyqtarët me dorë japin shenjë e paralajmërimit (*sinjalizimi nr. 17*). Skuadrës, e cila është në pronësi të topit i mundësohet që të ndryshojë mënyrën e organizimit të sulmit dhe në këtë mënyrë të pengojë marrjen e topit për shkak të lojës pasive. Nëse edhe pas tregimit të shenjës së paralajmërimit skuadra e cila gjendet në sulm nuk e ndryshon mënyrën e organizimit të sulmit ose nuk gjuan në portë, gjyqtarët gjykojnë gjuajtje të lirë në favor të skuadrës e cila nuk është në pronësi të topit (*shih Udhëzimin nr. 4*).

Në raste të veçanta (p.sh. mos shfrytëzimi me qëllim i situatës së qartë për shënim) gjyqtarët mund të gjykojnë gjuajtje të lirë edhe pa dhënien e shenjës paraprake të paralajmërimit.

RREGULLA 8 Faulat dhe Sjelljet Josportive

Veprimet e Lejuara

8:1 Lejohet:

- a) Të përdoret shuplaka e hapur për ta larguar topin nga shuplaka (dora) e lojtarit tjetër;
- b) Të përdoren duart e kërrusura për të krijuar kontakt trupor me kundërshtarin, dhe në këtë mënyrë përkujdeset dhe përcjell atë;
- c) Përdorimi i trungut për ta bllokuar kundërshtarin në luftë për pozitë.

SHPJEGIMI:

Bllokimi i nënkupton, parandalimi i kundërshtarit për të lëvizur në hapësirën e lirë, krijimin e bllokut, mbajtja e bllokut dhe largimi nga ai duhet në parim të bëhet në mënyrë pasive në raport me kundërshtarin (shih, megjithatë, 8:2 b)

Ndërhyrjet të cilët normalisht nuk çojnë deri te ndëshkimet personale progresive (keni parasysh, megjithatë kriteret për vendim-marrje në rregullën 8:3 a-d)

8:2 Nuk lejohet:

- a) Tërheqja ose goditur topin në duart e kundërshtarit;
- b) Bllokimi i kundërshtarit me krah, shuplaka, këmbë, ose të përdoret ndonjë pjesë e trupit për të zhvendosur atë apo larguar nga vendi; kjo përfshinë përdorimin e rrezikshëm të bërrylit, si në pozitë statike ashtu edhe në lëvizje;
- c) Kapja e kundërshtarit (trupin apo fanellën), edhe nëse ai mbetet i lire për të vazhduar lojën;
- d) Vrapimi ose kërcimi në kundërshtarin;

Ndërhyrjet te cilët kërkojnë ndëshkim personal sipas Rregullave 8:3-6

8:3 Ndërhyrjet, ku veprimi kryesisht apo ekskluzivisht është ndaj trupit të kundërshtarit, duhet të dërgoj deri te ndëshkimi personal. Kjo nënkupton që, si shtesë pos gjuajtjes së lirë apo 7-metërshit të paktën, ndërhyrja është për të u ndëshkuar në mënyrë progresive, të ndëshkohet me vërejtje (16:1), pastaj 2-minuta përjashtim (16:3b), dhe shkualifikim (16:6d).

Për ndërhyrje më të rëndë, ka 3 nivele që ndihmojnë në ndëshkimet në bazë të kriterëve të mëposhtme për vendim-marrje:

- Faulat të cilët duhet ndëshkuar menjëherë me 2 - minuta përjashtim (8:4);
- Faulat të cilët duhet ndëshkuar me shkualifikim (8:5);
- Faulat të cilët duhet ndëshkuar me shkualifikim dhe raporti me shkrimë është i obliguar (8:6);

Kriteret e Vendim – Marrjes:

Për të gjykuar si dhe cili ndëshkim personal është i duhur për ndërhyrje të veçanta, zbato kriteret e mëposhtme të vendim-marrjes; këto kriterë janë për të u përdorur si kombinim i duhur në çdo situatë:

- a) **pozita** e lojtarit ti cili shkakton ndërhyrje (pozita frontale, nga anash, nga prapa);
- b) **pozita e pjesës së trupit** ndaj së cilës është shkaktuar ndërhyrja e palejuar (trungut, krahut të gjuajtjes, këmbëve, kokës/gjoksit/qafës);
- c) **dinamika** e ndërhyrjes së palejuar (intensiteti i kontaktit të palejuar truporë, dhe/ose kur kundërshtari është në lëvizje të plotë);

d) **efektet** e ndërhyrjes së palejuar:

- ndikimi në trup dhe kontroll të topit
- zvogëlimi ose parandalimi i mundësisë për të lëvizur
- parandalimi i vazhdimit të lojës

Për gjykimin e ndërhyrjet është gjithashtu e rëndësishme edhe situata e lojës (p.sh. akti i gjuajtjes, vrapimi në hapësirë të lirë, situatë me intensitet të lartë të vrapimit).

Faultat të cilët duhet ndëshkuar menjëherë me 2-minuta përjashtim

8:4 Për faula të caktuar ndëshkimi është menjëherë 2-minuta përjashtim, pa marrë parasysh nëse lojtari ka marrë vërejtje më parë.

Kjo aplikohet veçanërisht tek ata ndërhyrje ku lojtari fajtorë e ka parasysh rrezikun për kundërshtarin (*shih gjithashtu 8:5 dhe 8:6*);

Duke marrë parasysh kriteret e vendim-marrjes në 8:3, ndërhyrjet e tilla mundë të jenë si:

- a) ndërhyrjet të cilat janë të shkaktuara me intensitet të lartë ose ndaj kundërshtarit i cili është duke vrapuar shpejtë;
- b) mbajtja e kundërshtarit për një kohë të gjatë, ose duke e rrëzuar atë;
- c) ndërhyrjet kundrejt kokës, gjoksit dhe qafës;
- d) goditja e fuqishme në trup ose dorës së gjuajtjes;
- e) tendenca për ta bërë kundërshtari që ta humbë kontrollin mbi trupin (p.sh. kapja e këmbës/shputës së kundërshtarit i cili është në kërcim; *shih gjithashtu 8:5a*);
- f) vrapimi apo kërcimi me shpejtësi të madhe në kundërshtarin.

Faultat të cilët duhet ndëshkuar me shkualifikim

8:5 Lojtari i cili e sulmon kundërshtarin në atë mënyrë e cila është e rrezikshme për shëndetin duhet shkualifikuar (16:6a). Rreziku kryesorë për shëndetin e kundërshtarit vije nga ndërhyrja i intensitetit të lartë ose nga fakti se kundërshtari është plotësisht i pa përgatitur për ndërhyrje dhe prandaj nuk mundë ta mbroj veten (shih Rregullën 8:5 Shpjegimin).

Përveç kriterëve 8:3 dhe 8:4, aplikohen gjithashtu kriteret e mëposhtme të vendim - marrjes:

- a) humbja momentale e kontrollit mbi trupin përderisa vrapon ose kërcen, ose gjatë aksionit për gjuajtje;
- b) ndërhyrja agresive ndaj pjesëve të trupit të kundërshtarit, sidomos fytyrë, gjoks dhe qafë; (intensiteti i kontaktit trupor);
- c) qëndrim i pamatur i demonstruar nga lojtari fajtorë kur shkakton ndërhyrje;

SHPJEGIMI:

Gjithashtu ndërhyrja me një influencë shumë të vogël trupore mundë të jetë shumë e rrezikshme dhe të çoj deri te lëndimet e rrezikshme. Nëse ndërhyrja është shkaktuar në momentin kur lojtari është duke kërcyer në ajër apo vrapon, dhe për këtë arsye nuk ka mundësi ta mbroj veten. Në këtë lloj situatë, është rreziku për kundërshtarin dhe jo intensiteti i ndërhyrjes që është bazë për gjykuar shkualifikim.

Kjo gjithashtu vlen edhe në ato situata kur portieri e lëshon hapësirën e vet, më qëllim të ndërprerjes së pasimit të bërë nga kundërshtari. Këtu portieri ka përgjegjësi të siguroj që të mos vije deri te situata që është e rrezikshme për kundërshtarin.

Ai duhet shkualifikuar nëse ai:

- a) arrin në posedim të topit, por në lëvizjet e ti shkakton përplasje me kundërshtarin;
- b) nuk mund ta kapë apo kontrollon topin, por shkakton përplasje me kundërshtarin;

Nëse gjyqtarët në njërën prej këtyre rasteve janë të bindur, se, pa ndërhyrjen e palejuar të portierit, kundërshtari do të ketë mundësi ta arrij topin, duhet gjykuar 7-metërs.

Shkualifikimi për shkak të ndërhyrjeve posaçërisht të pakujdesshme, posaçërisht të rrezikshme, të paramenduara ose me qëllim të keq (gjithashtu të raportohet me shkrim).

8:6 Nëse gjyqtari vëren ndonjë ndërhyrje që është posaçërisht e pakujdesshme, posaçërisht e rrezikshme, të paramenduar ose me qëllim të keq, ata duhet pas ndeshjes të shkruajnë raport me shkrim, në mënyrë që autoritetet përgjegjëse të jenë në gjendje të marrin një vendim në lidhje me masat e mëtutjeshme.

Indikacionet dhe karakteristikat që mundë të shërbejnë si kriter i vendim-marrjes përveç atyre në Rregullën 8:5 janë:

- a) ndërhyrje posaçërisht e pakujdesshme ose posaçërisht e rrezikshme;
- b) ndërhyrje e paramenduar ose me qëllim të keq, e cila në asnjë mënyrë nuk përputhet me situatën e lojës;

SHPJEGIMI:

Nëse ndërhyrja sipas Rregullës 8:5 ose 8:6 është shkaktuar gjatë minutës së fundit të lojës, me qëllim të parandalimit të golit, atëherë ndërhyrja është për të u konsideruar si "sjellje tejet e rëndë (ekstreme) josp sportive", dhe të ndëshkohet sipas Rregullës 8:10d.

Sjelljet josportive të cilat kërkojnë ndëshkim personal progresiv në bazë të Rregullës 8:7-10

Si sjellje jo sportive është për të u konsideruar çdo shprehje verbale edhe jo verbale e cila nuk është në përputhje me frymën e korrektësisë dhe të në mirë të sportit. Kjo vlen për të gjithë lojtarët dhe zyrtarët e të dy palëve, në fushë dhe jashtë saj. Për ndëshkimin e sjelljeve josportive, të rënda josportive edhe ekstreme josportive, dallimi është bërë në përmes 4 niveleve të ndërhyrjes.

- Ndërhyrjet të cilat duhet ndëshkuar në mënyrë progresive (8:7);
- Ndërhyrjet të cilët duhet ndëshkuar menjëherë me 2 - minuta përjashtim (8:8);
- Ndërhyrjet të cilat duhet ndëshkuar me shkualifikim (8:9);
- Ndërhyrjet të cilat duhet ndëshkuar me shkualifikim dhe raport me shkrim (8:10);

Sjelljet e rënda josportive që duhet ndëshkuar në mënyrë progresive

8:7 Sjelljet e më poshtme prej a-f janë shembuj të sjelljeve josportive të cilat duhet ndëshkuar në mënyrë progresive, duhet ndëshkuar me vërejtje (16:1b):

- a) reagimi ndaj vendimit të gjyqtarëve, ose veprimet verbale dhe jo verbale për shkak të vendimit të caktuar të gjyqtarëve;
- b) ngacmimi i kundërshtarit ose bashkë lojtarit përmes fjalëve ose gjesteve, ose gjuajtja (me top) në kundërshtarin në mënyrë që të shkaktoj hutë;
- c) pengimi (vonimi) i ekzekutimit të gjuajtjes së kundërshtarit, duke mos e respektuar distancën prej 3-metra ose në ndonjë mënyrë tjetër;
- d) përmes "aktrimit", përpiqet që ta mashtroj gjyqtarin në lidhje me veprimin e kundërshtarit ekzagjerimi i efektit të veprimit, me qëllim që të marr time-out dhe ndëshkim të pamerituar progresiv për kundërshtari;

- e) bllokimi i vazhdueshëm i pasimit duke përdorur këmbën; gjesti i pastër refleksiv , p.sh lëvizja e të dy këmbëve , nuk duhet ndëshkuar (*shih gjithashtu Rregullën 7:8*);
- f) Përsëritja e vazhdueshme e futjes në hapësirën e portierit për arsye taktike;

Sjelljet jospportive të cilat duhet ndëshkuar menjëherë me 2 minuta përjashtim

8:8 Disa sjellje jospportive për nga natyra e tyre shihen si më të rënda dhe duhet ndëshkuar menjëherë me 2-minuta përjashtim, pa marrë parasysh nëse lojtari apo zyrtari është ndëshkuar me vërejtje.

- a) protesta e përcjellur me zhurmë dhe gjete të shumta, ose sjellje provokuese;
- b) kur vendimi është kundër ekipit në posedim të topit, dhe lojtari me top nuk ja liron menjëherë kundërshtarit duke e lënë apo lëshuar topin në dysheme;
- c) pengimi për ta marr topin i cili ka kaluar në hapësirën për zëvendësime;

Sjelljet e rënda jospportive të cilat duhet ndëshkuar me shkualifikim

8:9 Disa nga format e sjelljeve jospportive konsiderohen si shumë serioze dhe ato kërkojnë shkualifikim. Sjelljet e mëposhtme janë shembuj të atyre sjelljeve:

- a) gjuajtja apo goditja e topit në mënyrë demonstrative, pas vendimit të gjyqtarëve;
- b) nëse portieri në mënyrë demonstrative nuk tenton ta ndal 7-metërshin;
- c) Goditja e qëllimshme me top e kundërshtarit gjatë ndërprerjes së lojës; nëse është bërë me forcë të madhe nga distanca e afërt, duhet të konsiderohet si një veprim tepër i pamatur sipas rregullës së mësipërme 8:6;

- d) kur gjuajtësi i 7-metërshit godet portierin në kokë, nëse portieri nuk e lëviz kokën në drejtim të topit;
- e) nëse ekzekutuesi i gjuajtjes së lirë godet në kokë mbrojtësin, nëse mbrojtësi nuk e lëvizë kokën në drejtim të topit;
- f) akti hakmarrijeje pasi që është fauluar.

SHPJEGIMI:

Në rast të 7-metërshit ose gjuajtjes së lirë, ekzekutuesi ka përgjegjësi të mos e rrezikoj portierin apo mbrojtësin.

Shkualifikimi për shkak të sjelljeve ekstreme josportive (gjithashtu të bëhet raport me shkrim)

8:10 Nëse gjyqtari e klasifikon sjelljen si ekstreme josportive, ata duhet paraqesin raport me shkrim pas ndeshjes, kështu që autoritetet përgjegjëse të jenë në pozitë të marrin vendim për masat e më-tutjeshme.

Veprimet e mëposhtme mundë të shërbejnë si shembuj:

- a) sjellje fyese apo kërcënuese drejtuar ndaj në presonit tjetër, p.sh., gjyqtarin, kohëmatësin/procesmbajtësin, delegatin, zyrtarin e ekipit, lojtarin, shikuesin; sjellja mundë të jetë në mënyrë verbale dhe jo verbale (p.sh., shprehje e fytyrës, gjestikulimi, gjuha trupore ose kontakti trupor).
- b) (I) interferenca në lojë nga zyrtari i ekipit, në fushën e lojës ose nga hapësira për zëvendësime, ose (II) prishja e situatës së qartë për shënim nga lojtari, ose gjuajtja në fushë e ndonjë gjësendi të palejuar (*Rregulla 4:6*) nga hapësira për zëvendësime;
- c) Nëse gjatë minutës së fundit të ndeshjes topi është jashtë lojës, dhe lojtari apo zyrtari i ekipit parandalon apo vonon gjuajtjen për kundërshtarin, me qëllim që ti parandaloj për të ardhur në pozitë për gjuajtje në gol ose për të krijuar situatë të qartë për shënim; kjo konsiderohet si ekstreme josportive, dhe aplikohet te çdo lloj interference (p.sh. vetëm pak kontakt fizik, ndërprerja e pasimit, pengesa me kapjen e topit, mos lëshuara e topit);
- d) nëse gjatë minutës së fundit të ndeshjes topi është në lojë, dhe kundërshtari bënë një ndërhyrje e cila i takon rregullës 8:5 ose 8:6 parandalimi i ekipit në posedim të topit për të ardhur në situatë për të gjuajtur apo të krijoj situatë të qartë për shënim, prandaj kjo nuk është për të u ndëshkuar vetëm me shkualifikim sipas 8:5 ose 8:6; duhet të bëhet ra-port me shkrim;

RREGULLA 9

Shënimi i Golit

9:1 Goli shënohet nëse topi me tërë perimetrin e tij ka kaluar vijën e portës (shih diagramin 4), me kusht që nuk është bërë shkelje e rregullave nga ekzekutuesi, bashkë-lojtarët ose zyrtari i ekipit të tij para ose gjatë gjuajtjes. Gjuqtari te porta sinjalizon me dy fishkëllima të shkurtra me pip dhe me sinjalizimin nr. 12 se është goli është shënuar.

Goli duhet të pranohet edhe në rastet kur ka shkelje të rregullave nga lojtari në por megjithatë topi futet në portë.

Goli nuk duhet të pranohet nëse gjuqtari, kohëmatësi ose delegati kanë ndërprerë lojën pra se topi ta kaloj komplet vijën e portës.

Goli duhet ti shënohet skuadrës kundërshtare nëse lojtari ka gjuajtur topin në portën e vetë, përveç në rastet kur portieri ekzekuton gjuajtjen e portierit (12:2, paragrafi 2).

SHPJEGIMI:

Goli duhet të pranohet nëse topi pengohet për të u futur në portë nga ndokush apo gjësendi i cili nuk është pjesë e lojës (shikuesi etj.), dhe gjuqtarët janë të bindur se në të kundërtën topi do të futej në portë.

9:2 Goli i pranuar nuk mundë të anulohet pasi që gjuqtari ka dhënë shenjë për ekzekutimin gjuajtjen pasuese nismëse. (shih, megjithatë, Rregullën 2:9 Shpjegimin).


Gjuqtarët duhet ta bëjnë të qartë (pa gjuajtje nismëse) se goli është pranuar, nëse dëgjohet sinjali për përfundimin e lojës apo gjysmë-lojës menjëherë pasi që goli të jetë shënuar dhe para se të mundë të kryhet gjuajtja nismëse.

SHPJEGIMI:

Goli duhet të shënohet në procesin e lojës menjëherë pasi që të jetë pranuar nga gjuqtarët.

9:3 Skuadra e cila ka shënuar më shumë gola se sa skuadra kundërshtare është fituese. Loja është e barabartë kur të dy skuadrat kan shënuar numër të njëjtë të golave apo nuk kanë shënuar fare gola (shih 2:2).

Diagrami 4: Shënimi i Golit



10:1 Në fillim të lojës, gjuajtjen nisëse e ekzekuton skuadra e cila ka fituar shortin dhe ka zgjedhur posedimin e topit. Skuadra kundërshtarë ka të drejt të zgjedh anën. Në rast se skuadra e cila e ka fituar shortin, dëshiron që ta zgjedhë anën e fushës, atëherë skuadra kundërshtarë e ekzekuton gjuajtjen nisëse.

Skuadrat i ndërrojnë anët e fushës për fillimin e pjesës së dytë të lojës. Gjuajtjen nisëse e ekzekuton skuadra e cila nuk e ka bërë këtë ne fillim të ndeshjes.

Shorti përsëritet para çdo vazhdimi të lojës, të gjitha dispozitat sipas Rregullës 10:1 aplikohen gjatë vazhdimëve.

10:2 Pas çdo shënimi të golit loja vazhdon me gjuajtje nisëse nga ekipi i cili ka pranuar golin (*shih, megjithatë, 9:2, paragrafi 2*).

10:3 Gjuajtja nisëse ekzekutohet nga qendra e fushës në cilindro drejtim (me tolerancë prej anësore 1.5 m), i paraprirë nga fishkëllima e gjuqtarit duhet të ekzekutohet brenda 3 sekondave (*13:1a, 15:7 paragrafi 3*). Lojtari i cili ekzekuton gjuajtjen nisëse duhet të pozicionohet me të paktën një këmbë vijën e mesit të fushës, dhe me tjetrën në ose para vijës (*15:6*), dhe duhet të mbetet në këtë pozicion deri sa topi ta lëshoj dorën e tij (*13:1a 15:7 paragrafi 3*) (*shih gjithashtu Udhëzimin nr. 5*).

Bashkë-lojtarët e ekzekutuesit nuk janë të lejuar ta kalojnë mesin e fushës par fishkëllimës së gjuqtarit (*15:6*).

10:4 Me rastin e ekzekutimit të gjuajtjes nisëse në fillim të çdo gjysmëloje (përfshirë këtu edhe vazhdimet) të gjithë lojtarët duhet të gjenden në gjysmën e fushës të vet.

Megjithatë, për gjuajtjen nisëse pas shënimit të golit, kundërshtarët e ekzekutuesit të gjuajtjes janë të lejuar të gjinden në të dy pjesët e fushës.

Megjithatë, në të dy rastet, kundërshtari duhet të jetë së paku 3 metra larg nga lojtari i cili ekzekuton gjuajtjen nisëse (*15:4, 15:9, 8:7c*).

11:1 Auti gjykohet atëherë kur topi me tërë perimetrin e kalon vijën e autit ose nëse lojtari në fushë i skuadrës mbrojtëse, e prek i fundit topin para se ai ta ketë kaluar vijën e gol-autit të skuadrës së tij.

Auti gjithashtu gjykohet edhe kur topi godet çatinë ose gjësendet e varura mbi fushë.

11:2 Auti ekzekutohet pa fishkëllimën paraprake të gjyqtarit (*shih, megjithatë, 15:5b*) nga kundërshtarët e skuadrës lojtari i së cilës i fundit ka prekur topin para se ai të kaloj vijën apo të prek çatinë apo gjësendet e varura në parket.

11:3 Auti ekzekutohet nga vendi ku topi ka kaluar vijën anësorë, ose nëse topi ka kaluar vijën e gol-autit, ekzekutohet në anën gjegjëse nga vendi ku takohen vija e autit dhe e gol-autit. Ekzekutimi i autit në rastet kur topi ka prekur çatinë apo gjësendet e varura mbi fushë bëhet nga vendi më i afërt të vijës anësore më të afërt në relacion me vendin ku topi ka prekur çatinë apo gjësendet e varura.

11:4 Ekzekutuesi duhet të qëndroj me një këmbë në vijën e autit (15:6) dhe të qëndroj në pozitë korrekte deri sa topi ta lëshoj dorën e tij (15:7 *paragrafi 2 dhe 3, 13:1a*). Nuk ka kufizime për këmbën tjetër se ku duhet të qëndroj.

11:5 Gjatë ekzekutimit të autit, lojtarët kundërshtarë nuk guxojnë të qëndrojnë më afër se 3 metra nga ekzekutuesi (15:4, 15:9, 8:7c).

Kjo nuk aplikohet, nëse ata qëndrojnë menjëherë jashtë vijës së hapësirës së portierit dhe pse distanca është më pak se 3 metra.

RREGULLA 12 Gjuajtja e Portierit

12:1 Gjuajtje e portierit gjykohet nëse (I) lojtari i skuadrës kundërshtare futet në hapësirën e portierit dhe bënë shkelje të Rregullës 6:2a; (II) portieri kontrollon topin në hapësirën e tij apo kur topi qëndron në dysheme në hapësirën e portierit (6:4-5); (III) lojtari i skuadrës kundërshtare ka prekur topin kur ai rrokulliset në dysheme në hapësirën e portierit (6:5, *paragrafi 1*) ose (IV) kur topi kalon vijën e gol-autit, pasi që është prekur nga portieri ose nga lojtari i skuadrës kundërshtare.

Kjo do të thotë se në të gjitha këto situata topi konsiderohet jashtë loje, dhe se loja rifillon me gjuajtje të portierit, (13:3) nëse ka shkelje të rregullave pasi të jetë gjykuar gjuajtje e portierit dhe para ekzekutimit të saj.

12:2 Gjuajtja e portierit ekzekutohet pa fishkëllimën paraprake të gjyqtarit (*shih, megjithatë, 15:5b*), prej hapësirës së portierit përtej vijës së hapësirës së portierit.

Gjuajtja e portierit konsiderohet e kryer, kur topi i ekzekutuar nga portieri dhe kalon komplet vijën kufizues të hapësirës së portierit.

Lojtarët e skuadrës kundërshtare janë të lejuar të qëndrojnë menjëherë pranë vijës së hapësirës së portierit, por nuk janë të lejuar ta prekin topin para se ai ta kalojë tërësisht vijën e kufizuese të hapësirës së portierit (15:4, 15:9, 8:7c).

Gjuajtja e lirë:

13:1 Në parim, gjyqtarët ndërprerjen lojën edhe e rifillojnë atë me gjuajtje të lirë për kundërshtarin nëse:

- a) skuadra në pronësi të topit bënë shkelje të rregullave e cila qon deri te humbja e pronësisë së topit: (*shih*, 4:2-3, 4:5-6, 5:6-10, 6:5, 6:7b, 7:2-4, 7:7-8, 7:10, 7:11-12, 8:2, 10:3, 11:4, 13:7, 14:4-7, 15:7 paragrafi 1, dhe 15:8).
- b) skuadra kundërshtare shkakton shkelje të rregullave që si pasoj shkakton ekipit në posedim të topit humbjen e tij (*shih* 4:2-3, 4:5-6, 5:5, 6:2b, 6:7b, 7:8, 8:2).

13:2 Gjyqtarët duhet të lejojnë rrjedhën e lojës duke iu shmangur ndërprerjeve të parakohshme të lojës duke gjykuar gjuajtje të lirë.

Kjo nënkupton se, në përputhje me Rregullën 13:1a, gjyqtarët nuk duhet të gjykojnë gjuajtje të lirë nëse skuadra mbrojtëse arrin në posedim të topit menjëherë pas ndërhyrjes së bërë nga skuadra e cila gjendet në sulm.

Ngjashëm, në përputhje me rregullën 13:1b, gjyqtarët nuk duhet të intervenojnë përderisa dhe përveç nëse është e qartë se skuadra sulmuese ka humbur posedimin e topit ose e ka të pamundur ta vazhdoj sulmin e saj, për shkak të ndërhyrjes së shkaktuar nga skuadra mbrojtëse.

Nëse duhet të jepet ndëshkim personal për shkak të shkeljes së rregullave, atëherë gjyqtarët mundë të vendosin që ta ndërprejnë lojën menjëherë, nëse kjo nuk shkakton dis-avantazh për kundërshtarin e skuadrës e cila ka kryer ndërhyrjen. Në të kundërtën ndëshkimi mundë të vonohet deri sa të përfundoj situata.

Rregulla 13:2 nuk aplikohet në rastet kur ka shkelje të rregullave 4:2-3 ose 4:5-6, normalisht kur loja duhet të ndërpritet për shkak të intervenimit të kohëmatësit.

13:3 Te ndërhyrjet që, në pajtim me rregullën 13.1a-b, kërkohet gjykimi i gjuajtjes së lirë, me ç'rast topi nuk gjendet në lojë, ndeshja do të vazhdojë me gjuajtjen e cila i përgjigjet arsyes së ndërprerjes së lojës.

13:4 Si shtesë për situatat e treguara në Rregullën 13:1 a-b, gjuajtja e lirë përdoret si mënyrë për të rifilluar lojën në situata të caktuara kur loja është ndërprerë (d.m.th. kur topi është në lojë), dhe nuk ka pasur shkelje të rregullave:

- a) nëse njëra nga skuadrat në momentin e ndërprerjes ka qenë në pronësi të topit, topi do të mbetet në pronësi të saj;
- b) nëse asnjëra nga skuadrat nuk gjendet në pronësi të topit, atëherë ekipit i cili i fundit ka luajtur me topi i jepet pronësia përsëri;

13:5 nëse gjykohet gjuajtje e lirë kundër skuadrës e cila është në pronësi të topit në momentin kur gjyqtari fishkëllejnë, lojtari i cili ka topin në atë moment duhet që menjëherë ta lëshojnë apo ta vendosin topin në dysheme, kështu që menjëherë mund të vazhdoj loja (8:8b).

Ekzekutimi i gjuajtjes së lirë

13:6 Gjuajtja e lirë normalisht ekzekutohet pa fishkëllimin paraprak të gjyqtarit (*shih, megjithatë, 15:5b*) dhe, në përcim, prej vendit ku ka ndodhur ndërhyrja. Përrashtimet e mëposhtme nga ky parim:

Situatat e përshkruara në rregullën 13:4 a-b, gjuajtja e lirë ekzekutohet pas fishkëllimës së gjyqtarit, në princip, nga vendi ku ka qenë topi në momentin e ndërhyrjes.

Nëse gjyqtari apo vëzhguesi (i IHF ose kontinental/federatës kombëtare) e ndërprejnë ndeshjen për shkak të shkeljeve nga ana lojtarëve apo zyrtarëve të skuadrës e cila gjendet në mbrojtje, dhe si rezultat i qortimit verbal ose ndëshkimit personal, gjuajtja e lirë ekzekutohet nga vendi ku topi ishte në momentin e ndërprerjes së lojës, nëse kjo është pozitë më e favorshme se sa ajo ku ka ndodhur ndërhyrja.

Përrashtim i njëjtë si ai i mëparshëm buhët edhe në rastet kur ndeshjen e ndërprejnë kohëmatësi për shkak të shkeljes sipas Rregullës 4:2-3 ose 4:5-6.

Siç është paraparë ne Rregullën 7:11, gjuajtja e lirë e gjykuar për shkak të lojës pasive duhet të ekzekutohet nga vendi ku ndodhej topi në momentin e ndërprerjes së lojës.

Pa i marrë parasysh principet dhe shpjegimet nga paragrafët e mësipërm, gjuajtja e lirë nuk mund të ekzekutohet kurrë brenda hapësirës së portierit të skuadrës, në favor të së cilës gjyqtarët kanë gjykuar gjuajtje të lira ose brenda vijës së gjuajtjes së lirë të skuadrës kundërshtarë.

Nëse vendi për ekzekutimin e gjuajtjes së lirë gjendet në hapësirën e cila është shënuar në paragrafin paraprak, atëherë është e domosdoshme që të zhvendoset në afërsi, jashtë hapësirës së cekur.

SHPEJGIMI:

Nëse gjuajtja e lirë është gjykuar mu në vijën kufizuese, 9 metra para portës së skuadrës, e cila gjendet në mbrojtje, gjuajtja e lirë duhet te ekzekutohet saktësisht nga vendi në të cilin është gjykuar ndërhyrja,

megjithatë, sa më larg që të jetë ku është shkaktuar ndërhyrja nga vija e 9-metërshit të ekipit mbrojtës, aq më e madhe duhet të jetë edhe toleranca sa i përket vendit nga i cili do të ekzekutohet gjuajtja e lirë. Kjo tolerancë gradualisht rritet deri në 3 metra, e cila aplikohet në rastin e ekzekutimit të gjuajtjes së lirë e jashtë hapësirës së portierit të ekipit të vet. Kjo tolerancë nuk vlen për gjuajtjet e lira në pajtim me rregullën 13.5, nëse është ndëshkuar sipas rregullës 8:8b. Në këto raste, gjuajtja e lirë duhet të ekzekutohet saktësisht nga vendi në të cilin është bërë ndërhyrja.

13:7 Lojtarët e ekipit ekzekutues nuk guxojnë ta prekin apo kalojnë vijën e gjuajtjeve të lira të kundërshtarit para se të kryhet ekzekutimi i gjuajtjes së lirë. Shih gjithashtu kufizimet e posaçme të cekura në Rregullën 2:5.

Gjyqtarët duhet ta korrigjon pozitën e lojtarëve të ekipit ekzekutues, të cilët gjenden në mes të vijës së gjuajtjes së lirë dhe vijës së 6 metërshit të ekipit kundërshtarë para se të ekzekutohet gjuajtja e lirë, nëse pozita jo e rregullt ka ndikim në lojë (15:3, 15:6). Gjuajtja e lirë duhet të përsëritet me fishkëllimën paraprake të gjyqtarit (15:5b). Procedurat e ngjashme aplikohen (Rregulla 15:7, paragrafi 2) lojtarët e skuadrës e cila ekzekuton gjuajtjen futen në zonën mes 6-metërshit dhe 9-metërshit gjatë ekzekutimit të gjuajtjes së lirë (para se topi ta lë dorën e ekzekutuesit), nëse ekzekutimi i gjuajtjes bëhet pa shenjën e gjyqtarit

Në rastet kur gjuajtja e lirë ekzekutohet me shenjën e gjyqtarit, kurse sulmuesit e prekin apo e kalojnë vijën e gjuajtje se lirë para se topi ta lëshon dorën e ekzekutuesit, duhet të gjykohet gjuajtje e lirë për skuadrën e cila gjendet në mbrojtje (15:7 paragrafi 3 dhe 13:1 a).

13:8 Më rastin e ekzekutimit të gjuajtjes së lirë lojtarët e skuadrës kundërshtare duhet të qëndrojnë larg së paku 3 metra nga ekzekutuesi. Ata, megjithatë, janë të lejuar të qëndrojnë pranë vijës së hapësirës së portierit të tyre nëse gjuajtja e lirë ekzekutohet në vijën e tyre të gjuajtjeve të lira. Ndërhyrja në ekzekutimin e gjuajtjes së lirë ndëshkohet në përputhje me Rregullën 15:9 dhe 8:7c.

RREGULLA 14 7-Metërshi

7-Metërshi Vendimi

14:1 7-metërshi gjykohet kur:

- a) situata e qartë për shënim pengohet në mënyrë të palejuar nga lojtari në fushë apo zyrtari i skuadrës kundërshtare;
- b) te fishkëllima e paarsyeshme në momentin e situatë së qartë për shënim;
- c) pengimi i situatës së qartë për shënim nga ndonjëri i cili nuk është pjesë e lojës, për shembull futja e shikuesit në fushë ose ndalja e lojtarit përmes fishkëllimës (përrjashtim bëhet kur aplikohet 9:1 shpjegimi). Për analogji, kjo rregull aplikohet në rastet "e forcës madhore", siç është ndërprerja e papritur e energjisë elektrike në momentin kur lojtari gjendet në situatë të qartë për shënim.

Shih Udhëzimin Nr. 6 mbi përcaktimin e situatës së qartë për shënim.

14:2 Nëse sulmuesi mbetet në kontroll të plotë të topit edhe trupit pavarësisht që ka pasur shkelje si në rregullën 14:1a, këtu nuk ka arsye të gjykohet 7-metërsh, edhe në qoftë se pas kësaj lojtari nuk arrin që ta shfrytëzoj situatën e qartë për shënim.

Sa herë që ka potencial për të gjykuar 7-metërsh, gjyqtarët duhet të përmbahen nga intervenimi deri sa ata mundë ta përcaktojnë qartë që gjykimi i 7-metërshit është vërtetë i arsyeshëm dhe i nevojshëm. Nëse lojtari sulmues shënon pavarësisht ndërhyrjes së palejuar të mbrojtësit, atëherë qartë nuk ka as një arsye për të gjykuar 7-metërsh. Anasjelltas, nëse bëhet e qartë se lojtari ka humbur topin dhe kontrollin e trupit për shkak të ndërhyrjes, dhe më nuk ekziston situata e qartë për shënim, në këtë rast duhet të gjykohet 7-metërsh.

14:3 Me rastin e gjykimit të 7-metërshit gjyqtarët mund të japin shenjë të time-out, por vetëm në raste kur ka vonesa të konsiderueshme, për shembull për shkak të zëvendësimit të portierit apo ekzekutuesit të gjuajtjes, dhe vendimi mbi time-out duhet të jetë në linjë me principet dhe kriteret të cilat gjenden në Udhëzimin nr. 2.

Ekzekutimi i 7-Metërshit

- 14:4** Gjuajtja e 7-metërshit duhet të ekzekutohet direkt në portë, brenda 3 sekondave pas fishkëllimës së gjyqtarit (15:7, paragrafi 3; 13:1a).
- 14:5** Lojtari i cili e ekzekuton 7-metërshin duhet ta marr pozitën mbrapa vijës së 7-metërshit, jo më larg se 1 metër mbrapa vijës (15:1, 15:6). Pas fishkëllimës së gjyqtarit, ekzekutuesit nuk i lejohet ta prek apo ta kaloj vijën e 7-metërshit para se topi ta lë dorën e ekzekutuesit (15:7, paragrafi 3, 13:1a).
- 14:6** Nuk guxon të luhet përsëri me top nga ekzekutuesi apo bashkëlojtari pas ekzekutimit të 7-metërshit, përderisa topi nuk e prek ndonjërin nga kundërshtarët apo kornizën e portës (15:7, paragrafi 3; 13:1a).
- 14:7** Tek ekzekutimi i 7-metërshit bashkëlojtarët e lojtarit i cili e ekzekuton 7-metërshin duhet të pozicionohen dhe të qëndrojnë jashtë vijës së gjuajtjes së lirë derisa topi ekzekutuesi ta lëshoj topin nga dora (15:3, 15:6). Në të kundërtën, do të gjykohet gjuajtje e lirë kundër skuadrës e cila ka ekzekutuar 7-metërshin (Rregulla 15:7 paragrafi 3, 13:1a).
- 14:8** Gjatë ekzekutimit të 7-metërshit lojtarët e skuadrës kundërshtare duhet të qëndrojnë jashtë vijës së gjuajtjes së lirë, njëkohësisht duhet të jenë më së paku 3 metra larg vijës për gjuajtjen e 7-metërshit përderisa topi nuk e lëshon dorën e ekzekutuesit. Në të kundërtën, 7-metërshi do të përsëritet nëse nuk rezulton me shënimin e golit.
- 14:9** 7-metërshi duhet të përsëritet nëse portieri kalon vijën kufizuese të tij, gjegjësisht vijën 4-metra (1:7, 5:11), përveç në rastet se kur është shënuar goli. Megjithatë, kjo nuk rezulton me ndëshkim personal për portierin.
- 14:10** Nuk lejohet zëvendësimi i portierit në kohën kur lojtari, me top në dorë duke qëndruar në pozitë të rregullt dhe është gati për të ekzekutuar 7-metërshin. Në këtë situatë çdo përpjekje për të bërë zëvendësim duhet të ndëshkohet si sjellje jospportive (8:7c, 16:1b dhe 16:3d).

RREGULLA 15

Udhëzimet e Përgjithshme Lidhur Me Ekzekutimin E Gjuajtjes (Gjuajtja - Nismëse, Autin, Gjuajtja e Portierit, Gjuajtja e Lirë dhe 7-Metërshin)

Ekzekutuesi:

15:1 Para ekzekutimit, ekzekutuesi duhet të jetë në pozitë të rregullt të paraparë për gjuajtje. Topi duhet të gjendet në duar e ekzekutuesit (15:6).

Gjatë ekzekutimit të gjuajtjes, përveç në rastet e degazhimit të portierit ekzekutuesi në momentin e gjuajtjes duhet të qëndrojë pandërprerë me një këmbë në dysheme para se ta lëshon topin, kurse këmben tjetër mund ta qoj nga dyshemeja dhe ta lëshojë sërish (*shih gjithashtu Rregullën 7:6*). Ekzekutuesi duhet të qëndron në pozitë të rregullt derisa të ekzekuton gjuajtjen (15:7, paragrafi 2 dhe 3).

15:2 Konsiderohet se gjuajtja është ekzekutua kur topi e lëshon dorën e ekzekutuesit (*shih, gjithashtu, 12:2*). Ekzekutuesi nuk guxon që sërish ta prek topin nëse me të nuk ka luajtur lojtari tjetër apo e ka prekur kornizën e portës (15:7, 15:8). Shiko përkufizimet plotësuese për situatat sipas Rregullës 14:6.

Bashkëlojtarët e Ekzekutuesit

15:3 Bashkëlojtarët duhet të marrin pozitën e rregullta për gjuajtje siç përshkruhet në (15:6). Lojtarët duhet të mbesin në pozitën e rregullta deri sa topi ta lëshoj dorën e ekzekutuesit, përveç si në 10:3, paragrafi 2.

Topi nuk guxon të preket ose të përcillet dorë në dorë nga bashkëlojtari gjatë ekzekutimit (15:7, paragrafi 2 dhe 3).

Goli mund të shënohet direkt nga çdo gjuajtje, përveç "auto-golit" të shënuar gjatë ekzekutimit të gjuajtjes së portierit (*p.sh., duke e lëshuar topin në portën e vetë*).

Lojtarët e Mbrojtjes

15:4 Lojtarët e mbrojtjes duhet ti marrin pozitën e rregullta siq janë të parapara për gjuajtje dhe të mbesin në pozitë të rregullta derisa topi ta lëshoj dorën e ekzekutuesit (15:9).

Pozitat e parregullta nga ana e lojtarëve të mbrojtjes në lidhje me gjuajtjen e lirë, gjuajtjen nismëse, ose autin nuk duhet të korrigjohet nga gjyqtarët nëse lojtarët e sulmit nuk janë në disavantazh për ekzekutimin e menjëhershme të gjuajtjes. Nëse ka disavantazh pozitë duhet të korrigjohet.

Shenja për Rifillimin e Ndeshjes

15:5 Gjyqtarët duhet të japin shenjë (fishkëllejnë) për të rifilluar lojën:

- a) gjithmonë në rast të gjuajtjes nismëse (10:3) ose 7-metërshit (14:4);
- b) në rast të autit, gjuajtjes së portierit ose gjuajtjes së lirë:
 - për ta rifilluar pas time-out-it;
 - për rifilluar me gjuajtje të lirë sipas Rregullës 13:4;
 - kur ka vonesë gjatë ekzekutimit;
 - pas korrigjimit të pozitave të lojtarëve;
 - pas paralajmërimit verbal ose vërejtjes.

Gjyqtarët mundën nëse e vlerësojnë se është e domosdoshme, në mënyrë që të qartësohet situata me fishkëllim të japin shenjë për vazhdim të lojës në çdo situatë tjetër.

Në parim gjyqtarët nuk janë të obliguar që më fishkëllim të japin shenjë për vazhdimin e ndeshjes deri sa respektohet kërkesa e pozitës së lojtarit gjatë ekzekutimit në pajtueshmëri me Rregullat 15:1, 15:3, 15:4 (*shih, megjithatë, 13:7, paragrafi 2 dhe 15:4 paragrafi 2*). Nëse gjyqtari me fishkëllimë jep shenjë për të u ekzekutuar gjuajtja, pavarësisht nga pozitën jo të rregullta nga ana e lojtarëve, këta lojtarë kanë plotësisht të drejtë të ndërhyjnë.

Pas fishkëllimës, ekzekutuesi duhet ta ekzekutojë gjuajtjen brenda 3 sekondave.

Sanksionet

15:6 Shkeljet e rregullave nga ekzekutuesi or bashkëlojtari para ekzekutimit të gjuajtjes, p.sh. zakonisht në formë të pozicionimit të parregullt ose prekje e topit nga bashkëlojtari, duhet të korrigjohet. (*shih, megjithatë, 13:7, paragrafi 2*).

15:7 Pasojat nga shkelja e rregullave nga ana e ekzekutuesit apo bashkëlojtarëve të tij (15:1-3) gjatë ekzekutimit të gjuajtjes varet së pari nëse është paraprirë nga fishkëllima për rifillimin e lojës.

Në parim, çdo shkelje që nuk është parapri me fishkëllimën për rifillim duhet të korrigjohet dhe të riekzekutohet pas fishkëllimës së gjyqtarit. Megjithatë, koncepti i përparësisë, në analogji me rregullën 13:2, aplikohet këtu. Nëse ekipi i ekzekutuesit e humbë topin menjëherë pas ekzekutimit jo korrekt të gjuajtjes, atëherë gjuajtja konsiderohet e kryer dhe loja vazhdon.

Në parim, çdo shkelje e rregullave gjatë ekzekutimit pas fishkëllimës për rifillimin e ndeshjes duhet të ndëshkohet. Kjo aplikohet, si p.sh. nëse ekzekutuesi kërcen gjatë ekzekutimit, e mban topin më shumë se 3 sekonda, ose largohet nga pozita e rregullt para se ta lëshoj topin nga dora. Aplikohet edhe kur bashkëlojtari lëviz në pozitë jo të rregullt pas fishkëllimës së gjyqtarit para se topi ta lëshoj dorën e ekzekutuesit. (*shih 10:3 paragrafin 2*). Në raste të këtilla gjuajtja nismëse duhet të merret dhe gjykohet gjuajtje e lirë për skuadrën kundërshtare (*13:1a*) nga vendi i shkeljes së rregullave (*shih, megjithatë, Rregullën 2:6*). Kusht për aplikimin e përparësisë sipas rregullës 13:2, p.sh. nëse ekipi i ekzekutuesit e humbë topin para se gjyqtarët të kenë mundësi për të intervenuar, loja vazhdon.

15:8 Në parim, çdo shkelje pas, por në lidhje me ekzekutimin e gjuajtjes duhet të ndëshkohet. Kjo ka të bëjë me shkeljen e rregullës 15:2, paragrafi 2, p.sh. ekzekutuesi prek për të dytën herë para se topi ta ketë prekur lojtarin tjetër apo portën. Kjo mund të ndodhë në formën e udhëheqjes së topit, kapjes së serishme të topit i cili ka qenë në ajër apo ka qenë i lëshuar në dyshe. Kjo sanksionohet me gjuajtje të lirë (13:1a) për kundërshtarin. Si në rastin e 15:7 paragrafi 3, aplikohet kushti i përparësisë.

15:9 Përveç rasteve të cilat janë cekur në rregullat 14:8, 14:9, 15:4 paragrafi 2 dhe 15:5 paragrafi 3, lojtari mbrojtës i cili pengon ekzekutimin e gjuajtjes nga ana e skuadrës kundërshtare p.sh. mos vendosja e rregullt para ekzekutimit të gjuajtjes, apo ardhja në pozitë të parregullt para se gjuajtja të ekzekutohet, duhet të ndëshkohet. Kjo aplikohet pa marrë parasysh se a është bërë thyerja e rregullave para apo pas ekzekutimit të gjuajtjes (para se topi ta lëshoj dorën e ekzekutuesi).

Gjithashtu njëjtë veprohet edhe në rastet, kur gjuajtjes i paraprinë fishkëllima nga gjyqtari për vazhdimin e lojës apo fishkëllima nuk ka qenë e nevojshme. Rregulla 8:7c aplikohet në ndërthurje me Rregullën 16:1b dhe 16:3d.

Nëse lojtari mbrojtës negativisht ka ndikuar në ekzekutimin e gjuajtjes, gjuajtja në parim do të përsëritet.

RREGULLA 16 Ndëshkimet

Vërejtja

16:1 Vërejtja është dënim i përshtatshëm për:

- a) ndërhyrjet të cilët duhet ndëshkuar në mënyrë progresive(8:3; megjithatë krahaso 16:3b dhe 16:6d);
- b) sjelljet josportive të cilat duhet ndëshkuar në mënyrë progresive(8:7);

SHPJEGIMI:

Të njëjtit lojtar nuk duhet t'i jepet më shumë se një vërejtje, dhe ekipit nuk duhet t'i jepet më shumë se 3 vërejtje: pas kësaj ndëshkimi duhet të jetë së paku 2 minuta përjashtim;

Lojtari i cili më herët kishte 2-minuta përjashtim nuk duhet që pastaj të i jepet vërejtje.

Jo më shumë se një vërejtje për të gjithë zyrtarët e ekipit.

16:2 Gjyqtari duhet të tregoj kartuçin e verdhë lojtarit fajtorë ose zyrtarit dhe kohëmatësit/procesmbajtësit duke mbajtur lartë kartuçin e verdhë (sinjali me dorë nr. 13).

Përjashtimi

16:3 Përjashtimi (2-minuta) është ndëshkim i përshtatshëm:

- a) për shkak të ndërrimit të parregullt, nëse në fushë hyn lojtari i tepërt, nëse lojtari nga hapësira e zëvendësimit të lojtarëve në mënyrë të palejueshme ndikon në lojë (4:5-6); shih, megjithatë, Rregullën 8:10b (II)
- b) për ndërhyrje si ato nën 8:3 nëse lojtari ose/dhe ekipi i tij veçse ka arritur maksimumin e numrit të vërejtjeve (shih 16:1 shpjegimin);
- c) për ndërhyrje si ata nën 8:4;
- d) për sjellje josportive nga lojtari sipas 8:7, nëse lojtari dhe/ose ekipi i ti veçse ka arritur maksimumin e numrit të vërejtjeve;

- f) për sjellje josportive nga lojtari ose zyrtari i ekipit sipas 8:8; shih gjithashtu 4:6;
- g) si pasojë e shkualifikimit të lojtarit apo zyrtarit të ekipit (16:8, paragrafi 2; shih megjithatë 16:11b);
- h) për sjellje josportive nga lojtari para se loja të rinisë, pasi që ai sapo është ndëshkuar me 2 minuta përjashtim (16:9a).

SHPJEGIMI:

Nuk është e mundur që zyrtarëve të ekipit të u jepet në përgjithësi ma shumë se 2 minuta përjashtim.

Kur zyrtarit të ekipit i tregohen 2 minuta përjashtim në përputhje me 16:3d-e, zyrtarit i lejohej të qëndroj në zonën e zëvendësimeve dhe ta kryej funksionin e tij. Megjithatë , numri i lojtarëve në fushë zvogëlohet për 2-minuta.

16:4 Pas dhënies së time-out, gjyqtari duhet të tregoj qartë përjashtimin lojtarit fajtorë ose zyrtarit të ekipit, dhe kohëmatësit/procesmbajtësit, përmes shenjës përkatëse me dorë, pra dora e zgjatur me dy gishta të zgjeruar (*sinjalizimi me dorë nr. 14*).

16:5 Përjashtimi gjithmonë zgjatë për 2 minuta kohë të lojës; përjashtimi i tretë për të njëjtin lojtarë gjithmonë shpie te shkualifikimi (16:6d)

Lojtarit të përjashtuar nuk i lejohej të marr pjesë në lojë gjatë kohës së përjashtimit, dhe ekipit nuk i lejohej ta zëvendësoi atë në fushë.

Koha e përjashtimit fillon kur loja rifillon me fishkëllimën e gjyqtarit.

Koha e 2 minuta përjashtim bartet në pjesën e dytë të lojës nëse nuk kanë përfunduar me përfundimin e pjesës së parë. E njëjta aplikohet nga koha e rregullt e lojës në kohën shtesë dhe gjatë kohës shtesë (vazhdimeve). Dhe 2 minuta përjashtim të papërfunduar në fund të kohës shtesë do të thotë që lojtari nuk ka të drejtë të marr pjesë në pasuese të ekzekutimit të 7-m në përputhje me 2:2 shpjegimin.

Shkualifikimi

16:6 Është ndëshkim i përshtatshëm për:

- a) për ndërhyrjet sipas 8:5 dhe 6:6;
- b) për sjellje serioze josportive sipas 8:9 dhe sjellje ekstreme josportive sipas 8:10, nga lojtari apo zyrtari i ekipit, në apo jashtë fushës;
- c) për sjellje josportive nga çdonjëri prej zyrtarëve të ekipit sipas 8:7, pasi që ata bashkërisht veçse kanë pranuar të dy, vërejtje dhe 2 minuta përjashtim në përputhshmëri me 16:1b dhe 16:3d-e;
- d) si pasojë e përjashtimit të tretë për të njëjtin lojtar (16:5);
- e) për sjellje të përsëritura josportive ose shprehëse gjatë vazhdimëve siç janë ekzekutimi i 7-m(2:2 shpjegimi dhe 16:10);

16:7 Pas shenjës për time-out, gjyqtari duhet që qartë të tregoj shenjën për shkualifikim lojtarit fajtorë ose zyrtarit të ekipit, dhe kohëmatësit / procesmbajtësit, duke mbajtur lartë kartuçin e kuq (sinjali me dorë n. 13).

16:8 Shkualifikimi i lojtarit apo zyrtarit të ekipit është për tërë kohën e mbetur të lojës. Lojtari apo zyrtari duhet që menjëherë të lëshoj fushën dhe zonën e zëvendësimit të lojtarëve. Pas largimit, lojtarit ose zyrtarit nuk i lejohet në asnjë formë të ketë kontakt me ekipin.

Shkualifikimi i lojtarit ose i përfaqësuesit të skuadrës gjatë kohëzgjatjes së lojës, qoftë në fushë, qoftë jashtë saj, gjatë zgjatjes së lojës gjithnjë bart automatikisht përjashtimin 2 min. për skuadër, kjo nënkupton reduktimin e numrit të lojtarëve të skuadrës së ndëshkuar në fushë (16:3f). Reduktimi në fushë do të zgjatë 4 min., nëse lojtari shkualifikohet sipas rrethanave që i parashih rregulla 16:12b-d.

Shkualifikimi e zvogëlon numrin e lojtarëve ose të zyrtarëve, të cilat janë në përbërje të skuadrës (përveç rregullës 16:11b). Mirëpo, skuadra ka të drejtë ta plotësojë numrin e lojtarëve në fushë, pas skadimit të kohës së përjashtimit prej 2min.

Siç është shënuar në rregullën 8:6 dhe 8:10, shkualifikimi në përputhje me këto rregulla duhet të raportohet me shkrim tek autoritetet përkatëse për veprimet e mëtutjeshme. Në raste të tilla, "përgjegjësi zyrtar i ekipit" dhe delegati (*shih udhëzimin nr. 7*), duhet të informohen menjëherë pas vendimit.

Më shumë se një shkelje së të njëjtën situatë

16:9 Nëse lojtari ose përfaqësuesi i skuadrës, para dhënies së shenjës për vazhdim të ndeshjes, njëkohësisht ose në vazhdimësi, bëjnë më tepër se një ndërhyrje dhe nëse ato ndërhyrje ndëshkohen me ndëshkime të ndryshme, atëherë medoemos duhet të shqiptohet në parim vetëm ndëshkimi më i rëndë.

Mirëpo, ekzistojnë disa përjashtime, në suaza të cilave, në të gjitha rastet, numri i lojtarëve të një skuadre në fushë reduktohet në kohëzgjatje prej 4 min.

- a) nëse lojtari, tashmë i përjashtuar në 2 min, para se të jepet shenja për vazhdimin e ndeshjes, sillet në mënyrë jo sportive, medoemos duhet ndëshkuar në mënyrë plotësuese edhe me 2 min përjashtim (16:3g), nëse ky ndëshkim plotësues për lojtarin është përjashtimi i tretë atëherë lojtari duhet shkualifikuar;
- b) nëse lojtari i cili është ndëshkuar me shkualifikim (drejtpërdrejt ose për shkak të përjashtimit të tretë me 2 min) para shenjës për vazhdim të lojës ka sjellje josportive, atëherë skuadrës i shqiptohet ndëshkimi plotësues dhe kështu reduktimi i lojtarit në fushë do të zgjatë 4 min. (16:8 paragrafi 2);
- c) nëse lojtari i cili veçse është ndëshkuar më 2-minuta përjashtim është fajtorë për sjellje serioze ose ekstreme josportive para se loja të rifilloj, atëherë lojtari përveç kësaj shkualifikohet (16:6c); ky ndëshkim i kombinuar sjell deri te 4-minuta reduktim (16:8, paragrafi 2);
- d) nëse lojtarit të cilit veçse është shkualifikuar (direkt ose për shkak të përjashtimit të tretë) është fajtor për sjellje serioze ose ekstreme josportive para se loja të rifilloj, atëherë ekipit i jepet ndëshkim shtesë kështu që reduktimi do të jetë për 4-minuta (16:8, paragrafi 2).

Ndërhyrjet gjatë kohëzgjatjes së lojës

16:10 Ndëshkimet për veprimet gjatë kohëzgjatjes së lojës janë të vendosura në rregullat 16:1, 16:3 dhe 16:6. Në koncept "kohëzgjatja e lojës" përfshinë të gjitha ndërprerjet time-out-at, time-out-at ekipor dhe kohën shtesë. Në të gjitha format e vazhdimëve (p.sh. gjuajtja e 7-m), aplikohet vetëm rregulla 16:6. Në këtë mënyrë çdo formë e sjelljeve të qëllimshme apo të përsëritura jospportive pengon pjesëmarrjen e mëtutjeshme të lojtarit në fjalë (*shih rregullën 2:2 shpjegimin*).

Ndërhyrjet jashtë kohëzgjatjes së lojës

16:11 Sjelljet jospportive, serioze jospportive, ekstreme jospportive, ose çdo formë e veprimeve pjesërisht të pamatur (*shih rregullën 8:6-10*) në pjesën e lojtarit ose zyrtarit të ekipit, që ndodhë në ambient ku loja është luajtur por jashtë kohëzgjatjes së lojës, duhet të ndëshkohet si në vijim:

Para lojës:

- a) vërejtja duhet të jepet në rast të sjelljeve jospportive sipas rregullës 8:7-8;
- b) shkualifikimi i lojtarit fajtor apo zyrtarit duhet të bëhet në rast të veprimeve që konsiderohen të jenë nën rregullën 8:6 dhe 8:10a, por ekipi është i lejuar të filloj me 14 lojtarë dhe 4 persona zyrtar; Rregulla 16:8, paragrafi 2 aplikohet vetëm për ndërhyrje gjatë kohëzgjatjes së lojës; në përputhje, shkualifikimi nuk shpie deri te 2-minuta përjashtim.

Ndëshkimet e tilla për shkelje para lojës mundë të zbatohen në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së lojës, kur do që personi fajtorë të zbulohet që merr pjesë në lojë, si arsye që nuk është e mundur të ndëshkohet gjatë kohës së incidentit.

Pas lojës:

- c) raport me shkrim

17:1 Çdo ndeshje e drejtojnë dy gjyqtarë të barabartë, të cilëve iu ndihmojnë matësi i kohës dhe procesmbajtësi.

17:2 Gjyqtarët e vëzhgojnë sjelljet e lojtarëve dhe të zyrtarëve të skuadrës prej momentit që ata futen në palestër e deri kur dalin nga ajo.

17:3 Gjyqtarët janë përgjegjës për kontrollimin e fushës së lojës, portave edhe topave para fillimit të ndeshjes; ata vendosin se cilët topa duhet të përdoren (1 dhe 3:1).

Gjyqtarët konstatojnë se a janë të dy skuadrat e pranishme dhe me pajisje të rregullta sportive, verifikojnë procesverbalin dhe pajisjen e lojtarëve. Ata duhet të sigurohen se numri i lojtarëve dhe i personave zyrtarë në zonën e zëvendësimeve është në pajtueshmëri me rregullat, dhe gjyqtarët duhet të identifikojnë dhe vërtetojnë prezencën e personave “zyrtarë të skuadrës” të të dy skuadrave. Çdo mospërputhje duhet të korrigjohet (4:1-2 dhe 4:7-9).

17:4 Hedhjen e shortit (10:1) e bënë njëri prej gjyqtarëve në praninë e gjyqtari tjetër dhe të “përfaqësuesit të skuadrës” të secilës skuadër, ose zyrtarit të skuadrës ose lojtarit (për shembull, kapiteni i skuadrës) në emër të “përfaqësuesit zyrtar”.

17:5 Në parim, e tërë ndeshja duhet të drejtohet nga gjyqtarët e njëjtë.

Është përgjegjësi e tyre që të sigurojnë se ndeshja është zhvilluar në përputhje me rregullat, edhe duhet ta ndëshkojnë çdo ndërhyrje apo shkelje të rregullave (*shih, megjithatë, 13:2 dhe 14:2*)

Nëse gjatë ndeshjes njëri nga gjyqtarët nuk është në gjendje që ta përfundoj lojën, gjyqtari tjetër i vetëm do ta përfundoj lojën.

Vini re: IHF, federatat kontinentale dhe nacionale kanë të drejtë të aplikojnë rregulla tjera në fushat e tyre të përgjegjësisë, duke u mbështetur në aplikimin e paragrafit 1 dhe 3 në rregullën 17:5.

17:6 Nëse të dy gjyqtarët gjykojnë një ndërhyrje dhe pajtohen se cila skuadër duhet ndëshkuar por kanë mendime të ndryshme për nga ashpërsia e dënimit, duhet të jepet më e ashpra nga të dy dënimet.

17:7 Nëse të dy gjyqtarët gjykojnë një ndërhyrje, ose topi e lëshon fushën e lojës, dhe gjyqtarët tregojnë mendime të ndryshme se cila skuadër duhet ta ketë pronësinë e topit, atëherë aplikohet vendimi i përbashkët i të dy gjyqtarëve pas konstatimit të përbashkët me njëri tjetrin. Nëse ata nuk arrijnë vendimin e përbashkët, atëherë to të vlej vendimi i gjyqtarit në fushës.

Të ketë rast time-out-i është i obliguar. Pas konsultimeve në mes të dy gjyqtarëve, ata tregojnë qartë sinjalin me dorë dhe loja rifillon pas fishkëllimës. (2:8d, 15:5).

17:8 Të dy gjyqtarët kanë për obligim për ti shënuar golat e arritura. Ata gjithashtu mbajnë shënime për vërejtje, përjashtime dhe shkualifikimet.

17:9 Gjyqtarët janë përgjegjës për të kontrolluar kohëzgjatjen e lojës. Nëse ka dyshime në lidhje me saktësinë e kohëmatësit, gjyqtarët marrin vendim të përbashkët (2:3).

Vini re: IHF, federatat kontinentale dhe nacionale kanë të drejtë të aplikojnë rregulla tjera në fushat e tyre të përgjegjësisë, duke u mbështetur në aplikimin e Rregullës 17:8 dhe 17:9.

17:10 Gjyqtarët kanë për obligim së pas ndeshjes të sigurojnë se procesverbali i ndeshjes është i përfunduar në mënyrë korrekte.

Shkualifikimi i llojit siç është treguar në rregullën 8:6 dhe 8:10 duhet të përshkruhet në raportin e ndeshjes.

17:11 Vendimi i marrë nga gjyqtarët në bazë të vërejtjeve dhe fakteve të tyre ose gjykimet e tyre janë përfundimtare.

Kundërshtimet mund të paraqitet vetëm ndaj vendimeve të cilat nuk janë në përputhje me rregullat.

Gjatë ndeshjes, vetëm "përfaqësuesi zyrtarë i ekipit" përkatës ka të drejtë të ju drejtohen gjyqtarëve.

17:12 Gjyqtarët kanë të drejtë ta ndërprerjen ndeshjen përkohësisht dhe përfundimisht.

Duhet bërë çdo përpjekje për ta vazhduar ndeshjen, para se të merret vendim për ndërprerjen përfundimtare të sajë.

17:13 Uniforma e zezë në rend të parë është paraparë për gjyqtarë.

17:14 Gjyqtarët dhe delegati mundë të përdorin pajisje elektronike për komunikimin e tyre intern. Rregullat për përdorimin e tyre përcaktohen nga federata përkatëse.

RREGULLA 18 Kohëmatësi dhe Procesmbajtësi

18:1 Kohëmatësi, në parim, e bart përgjegjësinë kryesore për matjen e kohëzgjatjes së lojës, të time-out-it të dhënë dhe të përjashtimeve kohore të lojtarëve.

Procesmbajtësi është përgjegjës për listat e lojtarëve, procesverbalin, kontrollin e hyrjes së lojtarëve të cilët arrijnë pas fillimit të ndeshjes, si dhe për hyrjen e lojtarëve të cilët nuk e kanë të drejtën e paraqitjes.

Detyrat tjera, si kontrollimi i numrit të lojtarëve dhe i përfaqësuesve të skuadrës në hapësirën për zëvendësimin e lojtarëve, si dhe vetë procesi i ndërrimit të lojtarëve janë përgjegjësi e tyre e përbashkët.

Në parim, vetëm kohëmatësi (dhe, delegati i ndeshjes nëse parashihet nga federata përkatëse) duhet ta ndërpres ndeshjen nëse e sheh se është e nevojshme.

Shih gjithashtu Udhëzimin Nr. 7 bazuar në procedurave të parapara për kohëmatësin/procesmbajtësin kur përmbushen disa nga përgjegjësitë e përshkuara më lartë.

18:2 Nëse nuk ekziston pajisja publike për matjen e kohës (semafori), kohëmatësi është i obliguar t'i njoftojë përfaqësuesit e skuadrave për kohën e cila është luajtur dhe e cila duhet luajtur, sidomos me përfundim të time-out-it.

Nëse nuk ekziston pajisja publike për matjen e kohës me sinjal automatik të zëshëm (semafor), kohëmatësi e merr përgjegjësinë për përfundimin e gjysmë lojës, gjegjësisht të ndeshjes (*shiko* 2:3).

Nëse pajisja elektronike (semafori) nuk është në gjendje ta paraqes kohën e përjashtimeve (së paku për 3 lojtarë për secilën skuadër gjatë garave të IHF-it) kohëmatësi duhet ta shkruaj në karton (letër) në tavolinën zyrtare, që tregon kohën e skadimit të përjashtimi së bashku me numrin e fanellës së lojtarit të përjashtuar.

SINJALIZIMI ME DORË SIPAS IHF

Kur gjykohej aut apo gjuajtje e lirë, gjyqtarët duhet menjëherë të tregojnë drejtimin e gjuajtjes si më poshtë (sinjali 7 ose 9).

Pas kësaj, varësisht prej situatës së dhënë, duhet treguar shenjë të paraparë të dorës me të cilën sinjalizohet për çdo ndëshkim personal (sinjalizimi nr. 13 - 14).

Nëse gjyqtarët do të shohin të arsyeshme për t'i sqaruar shkaqet e dhënies së gjuajtjes së lirë ose shtatëmetërshit, ata me qëllim të informimit të lojtarëve mund të tregojnë shenjat 1 - 6 dhe 11. (Sinjalizimi nr. 11 do të duhej ta tregonin gjithmonë nëse para gjykimit të gjuajtjes së lirë, për shkak të lojës pasive, nuk është dhënë paraprakisht sinjali nr. 17).

Sinjalizimet, nr. 12, 15 dhe 16, janë të obligueshme në të gjitha situatat gjegjëse.

Sinjalizimet, nr. 8, 10 edhe 17, gjyqtarët do t'i tregojnë në rastet kur ata vlerësojnë se janë të nevojshme.

Lista e sinjaleve të IHF-it

Faqe

1. Cenimi i Hapësirës së portieri	1
2. Driblim i (udhëheqje) Gabuar e topit	2
3. Gabim në Hapa ose mbajtja e topit më shumë se 3 sekonda	
4. Kapja, Mbajtja, Shtyrja	
5. Goditja	
6. Faul në Sulëm	
7. Auti – Kahja	
8. Gjuajtje e portierit	
9. Gjuajtja e lirë - Kahja	
10. Mbajtja e distancës prej 3m	
11. Loja pasive	
12. Goli (shënimi	
13. Vërejtja (i verdhë); shkualifikim (i kuq)	
14. Përrjashtim (2-minuta)	
15. Time-out	
16. Leja për futjen e dy personave (që kanë të drejtë pjesëmarrje) në fushë gjatë time-out-it	
17. Shenja paralajmëruese për lojë pasive	

1.

Cenimi i Hapësirës
së portierit



2.

Driblim i (udhëheqje)
Gabuar e topit



3.

Gabim në Hapa ose
mbajtja e topit
më shumë se 3 sekonda



4.

Kapja, Mbajtja, Shtyrja



5.
Goditja



6.
Faul në Sulëm



7.

Auti – Kahja



8.

Gjuajtje e portierit



9.

Gjuajtja e lirë - Kahja



10.

Mbajtja e distancës prej 3m



11.

Loja pasive



12.

Goli (shënimi)



13.

Vërejtja (i verdhë);
shkualifikim (i kuq)



14.

Përgjashtim (2-minuta)



15.

Time-out



16.

Leja për futjen e dy
personave (që kanë të
drejtë pjesëmarrje) në fushë
gjatë time-out-it



17.

Shenja paralajmëruese për
lojë pasive



Udhëzime për Aplikimin e Rregullave të Lojës

Udhëzimi 1

Ekzekutimi i Gjuajtjes së Lirë pas Shenjës për Përfundimin e Ndeshjes (2:4-6)

Në të shumtën e rasteve, skuadra e cila ka mundësinë për të ekzekutuar gjuajtjen ë lirë pasi që kohëzgjatja e lojës ka përfunduar nuk është e vërtetë e interesuar për të tentuar që të shënoj gol, ose për shkak se përfundimi i ndeshjes është i qartë ose për shkak se pozita për ekzekutimin e gjuajtjes së lirë është shumë larg nga porta kundërshtare. Megjithatë teknikisht rregullat e lojës kërkojnë të kryhet ekzekutimi i gjuajtjes së lirë, gjyqtarët duhet të tregojnë gjykim të mirë dhe të konsiderojnë se gjuajtja e lirë është kryer nëse lojtari i cili gjendet në pozitë përafërsisht të rregullt thjeshtë e lëshon topin ose ia dorëzon gjyqtarit.

Në ato raste kur është e qartë që skuadrat dëshirojnë të shënojnë gol, gjyqtarët duhet të gjejnë një ekuilibër për të lejuar këtë mundësi (edhe nëse është shumë e vogël) dhe sigurojnë që situata të mos shndërrohet në humbje kohe dhe frustruese “teatër”. Kjo do të thotë që gjyqtarët duhet shumë shpejt ti vendos lojtarët e të dy skuadrave në pozita korrekte në mënyrë që gjuajtja e lirë të ekzekutohet pa u vonuar. Përkufizimet e reja në Rregullën 2:5 në lidhje me pozitën e lojtarëve dhe zëvendësimet duhet të zbatohen (4:5 dhe 13:7).

Gjyqtarët duhet të jenë shumë vigjilent nga shkeljet e tjera të dënueshme të Rregullave nga të dy skuadrat. Cenimet e vazhdueshme nga ana e mbrojtësit duhet të ndëshkohen (15:4, 15:9, 16:1b, 16:3d). Gjithashtu, lojtarët sulmues shumë shpesh bëjnë shkeljen e rregullave gjatë ekzekutimit, p.sh. një apo më shumë lojtarë kalojnë vijën e gjuajtjes së lirë pas fishkëllimës por para ekzekutimit të gjuajtjes (13:7, paragrafi 3), ose ekzekutuesi në momentin e ekzekutimit lëvizë apo kërcen (15:1, 15:2, 15:3).

Është shumë e rëndësishme që të mos lejohet asnjë shënim i parregullt.

Udhëzimi 2

Time-Out-i (2:8)

Përveç situatat e përshkruar në Rregullën 2:8 dhe të cilat time-out-i është i obligueshëm, nga gjyqtarët pritet që edhe në situata tjera të sjellin vendime mbi nevojën e gjykimit të time-out-it. Disa prej situatave në të cilat gjykimi i time-out-it nuk është i obligueshëm, por nën rrethana normale prapëseprapë do të duhej të gjykohen janë:

- a) faktori i jashtëm, p.sh. pastrimi i fushës;
- b) lojtari duket të jetë lënduar;
- c) skuadra shihet haptas se donë të fitojë në kohë, p.sh. kur zvarrit ekzekutimin e ndonjëres nga gjuajtjet e gjykuara, ose kur lojtari e gjuan topin ose nuk e lëshon në dysheme pas ndërhyrjes së gjykuar;
- d) topi e prek tavanin ose pjesë të konstruksionit mbi fushë dhe në këtë mënyrë dëbohet më larg nga vendi nga i cili do të duhej të ekzekutohej gjuajtja (11:1), gjë që prapë sjell në humbjen e panevojshme të kohës.

Për përcaktimin e nevojës së gjykimit të time-out-it në këto dhe në situatat tjera, gjyqtarët gjithashtu duhet të kenë në konsideratë nëse e lojës pa time-out do të krijonte disavantazh të padrejtë për njërën nga skuadrat. Për shembull, nëse njëra prej skuadrave, para fundit të lojës, ka përparësi të madhe, nuk ekziston ndoshta nevoja që gjatë kohës së ndërprerjes së shkurtës të ndeshjes, për shkak të pastrimit të dyshemesë, të gjykohet time-out. Ngjashëm, nëse skuadra e cila do të jetë në disavantazh nga mos gjykimi i time-out-it është skuadra e cila, për disa arsye, i shkakton vetes vonesa ose humbje kohe, prandaj këtu qartë nuk ka asnjë arsye për të gjykuar time-out.

Një fakt tjetër i rëndësishëm është kohëzgjatja e pritshme e ndërprerjes. Kohëzgjatja e ndërprerjes në rastë të lëndimit të lojtarit shpesh është vështirë të vlerësohet, kështu që do të ishte më e sigurtë për të gjykuar time-out. Anasjelltas, gjyqtarët nuk duhet të nguten të gjykojnë time-out vetëm pse topi ka dalë nga fusha. Në këto rastë shumë shpesh topi kthehet në fushë edhe është gati për lojë pothuajse menjëherë. Nëse jo, gjyqtarët duhet të koncentrohen që sa më parë ta sjellin topin

rezerve në lojë (3:4), në mënyrë për të ju shmangur time-out-it të panevojshëm.

Është hequr time-out-i i bliguar në lidhje me ekzekutimin e 7-metërshit. Mundë të jetë i nevojshëm gjykimi i time-out-it në disa raste bazuar në subjektin e gjykimit, në përputhje me parimet e diskutuara më lartë. Kjo mundë të përfshij situatën kur njëra nga skuadrat në mënyrë të qartë vonon ekzekutimin e gjuajtjes, duke përfshirë këtu zëvendësimin e portierit apo ekzekutuesit.

Udhëzimi 3

Time-Out-i Ekiporë (2:10)

Në kuadër të kohëzgjatjes së rregullt të ndeshjes (por jo edhe gjatë vazhdimit) secila skuadër ka të drejtë të ketë nga një time-out gjatë gjysëmlojës, i cili zgjat një minutë.

Përfaqësuesi zyrtar i skuadrës, i cili dëshiron të kërkojë time-out ekipor është i obliguar që në tavolinën para kohëmatësit të vendosë "kartonin e gjelbër" (preferohet që kartoni i gjelbër ta ketë formën prej 15 x 20 cm dhe nga dyja anët të jetë e shënuar shkronja e madhe "T").

Skuadra mund të kërkojë tajm-aut ekipor vetëm në rastin kur gjendet në pronësi të topit (kur topi është në lojë ose gjatë ndërprerjes). Me kusht që skuadra të mos humbë pronësinë e topit para se kohëmatësi të japë sinjalin gjegjës (në të kundërtën kartoni i gjelbër për time-out-it i kthehet skuadrës). Time-out-i ekipor gjykohet menjëherë.

Kohëmatësi në atë rast me fishkëllimë ndërpret lojën (2:9). Jep shenjën e paraparë të time-out (sinjalizimi nr. 15) dhe me dorë të zgatur tregon në drejtim të skuadrës e cila e ka kërkuar time-out-in

Kartoni i gjelbër vendoset në atë gjysmë të tavolinës së procesmbajtësit e cila është më afër skuadrës e cila ka kërkuar time-out-in dhe aty qëndron deri në përfundimin e time-out-it ekipor.

Gjyqtarët japin shenjën për time-out, ndërsa kohëmatësi e ndal orën për matjen e kohës - semaforin. Gjyqtarët e vërtetojnë se skuadrës iu është dhënë e drejta për shfrytëzimin e time-out-it ekipor dhe pas kësaj kohëmatësi aktivizon orën e veçantë e cila kontrollon kohëzgjatjen e time-out-it ekipor. Procesmbajtësi shënon në procesverbal kohën kur skuadra ka kërkuar time-out në rubrikën për gjysmëlojën gjegjëse dhe për skuadrën e cila ka shfrytëzuar të drejtë për time-out ekipor.

Gjatë kohës së time-out-it ekipor lojtarët dhe përfaqësuesit e skuadrave gjenden në hapësirën e tyre për zëvendësimin e lojtarëve dhe atë ose në fushë, ose brenda hapësirës për zëvendësimin e lojtarëve. Gjyqtarët mbeten në qendër të fushës, ose njëri prej dy gjyqtarëve, me qëllim të ndonjë marrëveshjeje eventuale për kohë të shkurtër, mund të shkojë deri te tavolina e procesmbajtësit.

Për qëllim të ndëshkimeve progresive sipas Rregullës 16, time-out-i ekiporë është definuar të jetë pjesë e kohëzgjatjes së lojës (16:10), kështu që çdo sjellje jospportive edhe ndërhyrje tjetër ndëshkohen në mënyrë normale. Në këtë kontekst është e parëndësishme nëse lojtari/zyrtari në fjalë është në apo jashtë fushës. Në përputhje me rrethanat, vërejtja, përjashtimi apo shkualifikimi sipas Rregullës 16:1-3 dhe 16:6-9 mundë të shqiptohet për shkak të sjelljes jospportive (8:7-10) ose për veprimet e parapara sipas Rregullës 8:6b.

Pas 50 sekondave kohëmatësi, me sinjal akustik, sinjalizon se loja do të vazhdohet pas 10 sekondave.

Skuadrat janë të obliguara që pas skadimit të time-out-it ekipor të jenë të gatshme për vazhdimin e lojës. Loja vazhdon ose me gjuajtje që i përgjigjet situatës e cila ka mbretëruar në fushë para lejimit të time-out-it ekipor, ose nëse topi ka qenë në lojë me gjuajtje të lirë në dobi të skuadrës e cila ka kërkuar time-out-it ekipor dhe atë nga vendi në të cilin ka qenë topi në kohën e ndërprerjes.

Së bashku me fishkëllimën e gjyqtarit, kohëmatësi aktivizon rishtas pajisjen për matjen e kohës - semaforin.

Udhëzimi 4

Loja Pasive (7:11-12)

A. Udhëzime të përgjithshme

Dispozitat e rregullave në lidhje me lojën joaktive (pasive) kanë për qëllim që të pengojnë mënyrën jo atraktive të lojës, gjegjësisht "vjedhjen" e qëllimshme të kohës. Parakusht për diçka të tillë është që gjyqtarët, gjatë tërës ndeshjes, në mënyrë të njëjtë, ta njohin lojën joaktive dhe po ashtu - njëjtë dhe thjesht - ta sanksionojnë.

Loja joaktive (pasive) mund të vijë gjatë të gjitha fazave të organizimit të sulmit nga ana e një skuadre, pra gjatë kohës së kalimit në gjysmën e skuadrës kundërshtare, gjatë fazës së organizimit të sulmit dhe gjatë përfundimit.

Mënyrat pasive të lojës përdoren në mënyrë tipikë shumë shpesh në këto situata:

- Skuadra ka epërsi të vogël në rezultat, para së gjithash para përfundimit të ndeshjes,
- Skuadra në sulm ka lojtarin e përjashtuar
- epërsia e njërës skuadër, sidomos në mbrojtje.

Kriteret e cekura në situatat specifike rrallë aplikohen të vetmuara, por në përgjithësi duhet të gjykohen si tërësi nga gjyqtari. Veçanërisht, ndikimi i punës së mbrojtjes aktive në pajtim me rregullat duhet të merret parasysh.

B. Përdorimi i shenjës paralajmëruese

Shenja e paralajmërimit për lojën pasive duhet të tregohet në këto raste:

B1. Paralajmërimi gjatë ndërrimit ose ndërrimit shumë të ngadalshëm të lojtarëve, përkatësisht kalimit të ngadalshëm në gjysmën e fushës së skuadrës kundërshtare.

Rastet tipike janë:

- pritja e lojtarëve në mes të fushës që të kryhet zëvendësimi i lojtarëve,

- Lojtari zvarrit me ekzekutimin e gjuajtjes së lirë (duke e pasuar topin në mes veti apo simulon se nuk e dinë vendin nga duhet të ekzekutohet gjuajtja), gjuajtjes nisëse (duke e marrë ngadalë topin nga portieri, duke e rrokullisur topin me ngadalësi dhe duke e hedhur topin në drejtim të qendrës së fushës ose duke ardhur në mënyrë të ngadalësuar në drejtim të qendrës së fushës), gjuajtjen e portierit apo autin, pasigje skuadrës ju është dhënë vërejtja për zvarritje të lojës.
- udhëheqja e topit në vend nga lojtarët,
- kthimi i topit në gjysmën e fushës, pa sulmim nga ana e lojtarëve kundërshtar.

B2. Paralajmërimet gjatë ndërrimit të vonuar të lojtarëve gjatë fazës së organizimit të sulmit.

Rastet tipike janë:

- të gjithë lojtarët kanë zënë pozitat e tyre në sulm;
- skuadra e ka filluar organizimin e sulmit duke luajtur me top rreth zonës;
- deri në momentin kur skuadra nuk tenton ndërrimin e lojtarëve.

SHPJEGIMI:

Skuadra e cila nga gjysma e vetë e fushës nisat në kundërsulm të shpejtë, por nuk e arrin rastin për shënim, ka të drejtë që pas kësaj të kryen zëvendësimin e lojtarëve.

B3. Paralajmërimi për shkak të fazës së tej zgjatur të organizimit të sulmit.

Skuadra që gjendet në sulm parimisht ka të drejtë që nëpërmjet pasimit të topit të organizojë sulmin e vet.

Treguesit tipik që tregojnë fazën e tej zgjatjes së organizimit të sulmit janë:

- skuadrës në sulm nuk i vjen për dore që të krijojë rast për arrijtje të shënimit.

SHPJEGIMI:

Rasti për arritje të shënimit krijohet ashtu që skuadra iu ikën mjeteve taktike me qëllim që të arrijë përparësi hapësinore në raport me skuadrën e cila gjendet në mbrojtje, përkatësisht të realizojë ndryshim të qartë të ritmit të lëvizjeve në krahasim me fazën e përgatitjes së sulmit);

- pranimi i shpeshtë i topit gjatë qëndrimit në vend ose gjatë lëvizjes prapa duke u larguar nga porta;
- goditja (udhëheqja) e shumëfishtë e topit në dysHEME në të njëjtin vend;
- në kontakt me lojtarin kundërshtar, lojtari sulmues shumë herët kthehet dhe pret që gjyqtari të japë shenjë për ndërprerjen e lojës, apo nuk ka qëllim të fitoi përparësi ndaj lojtarit mbrojtës
- loja aktive në mbrojtje: mënyra aktive e lojës së lojtarëve mbrojtës pengon ndryshimin e ritmit të lëvizjeve të lojtarëve të skuadrës e cila është në sulm.
- skuadra në sulm nuk tenton të shpejtojë lojën në mes të organizimit të sulmit për realizimin e fazës së sulmit.

C. Si duhet të përdoret sinjali paralajmërues

Nëse gjyqtari (ose gjyqtari i fushës ose gjyqtari te porta) e njeh shfaqjen e lojës pasive, nëse e ngrit dorën (sinjalizimi me dorë nr. 17), për ta marr vendimin për ekipin i cili nuk është duke tentuar që të vije në pozitë për të gjuajtur në portë. Gjyqtari tjetër duhet gjithashtu ta shenjë paralajmëruese.

Sinjali paralajmërues vije si pasojë që ekipi i cili është në posedim të topit nuk tenton që të krijoj situatë për shënim, ose vonesa të vazhdueshme për gjuajtje nisëse.

Sinjali me dorë mbahet deri më:

- Përfundimin e sulmit, ose
- Shenja paralajmëruese nuk është e vlefshme (shih këshillat e mëposhtme).

Sulmi i cili fillon me posedimin e topit konsiderohet se është i kryer kur skuadra shënon apo e humb pronësinë e topit.

Shenja paralajmëruese normalisht aplikohet për të gjithë kohën e mbetur të sulmit. Megjithatë gjatë rrjedhës së sulmit, janë dy situata ku gjykimi për lojë pasive nuk është më i vlefshëm, dhe shenja paralajmëruese duhet të ndërpritet:

- a) ekipi në posedim të topit gjuan në portë dhe topi kthehet tek i njëjti ekip nga korniza e portës apo portieri (direkt apo në formë të autit)
- b) lojtarit apo zyrtarit të ekipit mbrojtës i jepet ndëshkim personal progresiv sipas rregullës 16 për shkak të faulit apo sjelljeve josp sportive.

Në këto dy situata, ekipit në posedim duhet të i lejohet një fazë e re e organizimit të sulmit.

D. Pasi që shenja paralajmëruese është treguar

Pasi që tregohet shenja paralajmëruese, gjyqtari duhet ti lejoj pak kohë ekipit në posedim të topit ti ndryshoj veprimet. Në lidhje me këtë, niveli i shkathtësive të grupmoshave të ndryshme dhe efektshmëria e kategorive të ndryshme duhet të merren parasysh.

Ekipi i paralajmëruar duhet që në vazhdim të i jepet mundësia të përgatitë sulm drejt portës.

Nëse ekipi në posedim të topit nuk krijon tentim të qartë që të vijë në pozitë për të gjuajtur në port, njëri nga gjyqtarët gjykon lojë pasive (Rregulla 7:11-12). (shih gjithashtu mëposhtë 'kriteret e vendimarrjes pas tregimit të shenjës paralajmëruese').

SHPJEGIMI:

Nuk guxon të gjykohet lojë pasive nëse e ekziston mundësia për gjuajtje në portë apo lojtari me top bënë të qartë që është i gatshëm të gjuaj në portë.

Kriteret e vendim-marrjes pas tregimit të shenjës paralajmëruese

D1. Ekipi sulmues

- qartë nuk e përshpejton ritmin
- nuk ka qëllim për të shënuar
- me lojë 1 në 1 nuk është arritur përparësi në hapësirë
- zhagjitjet (p.sh. hapësirat janë të mbuluara nga lojtarët e mbrojtjes)

D2. Ekipi mbrojtës

- Ekipi mbrojtës tenton ta parandaloj përshpejtimin e ritmit ose veprimet me cak, përmes metodave aktive dhe korrekte
- Loja pasive nuk duhet gjykuar nëse mbrojtja agresive ndërhyr në rrjedhën e sulmit vazhdimisht përmes faulave.

E. Shtojcë

Treguesit e ritmit të ngadalësuar

- Veprimet anash dhe jo në drejtim të portës.
- Vrapime të vazhdueshme diagonale përball lojtarit mbrojtës pa dëshirë për ta sulmuar.
- Pa aksione në thellësi, siç janë duelet 1 me 1 ose pasimi i topit tek lojtari i cili gjendet në mes të vijës së 6m dhe 9m.
- Pasimet e përsëritura në mes të dy lojtarëve pa rritje të qartë të intensitetit apo aksion drejt portës.
- Pasimi i topit përfshirë të gjitha pozitat (alot, pilotin dhe lojtarët fundor) pa rritje të qartë të ritmit ose aksion të qartë drejt portës.

Treguesit e dueleve 1 me 1 kur nuk arrihet përparësi në hapësirë.

- 1-me-1 aksion ku situata është e qartë se nuk mundë të kalohet përtej (disa kundërshtar e bllokojnë shtegun për të depërtuar.)
- 1-me-1 aksione pa ndonjë qëllim për të depërtuar drejt portës
- 1-me-1 aksion me të cilin qëllimi kryesor është te fitohet vetëm gjuajtje të lirë (p.sh. mbërthyerja e qëllimshme,ose përfundimi
- 1-me-1 aksionit edhe nëse ka pas mundësi të vazhdoj depërtimin tutje)

Treguesit e metodave aktive të mbrojtjes në pajtim me rregullat

- Tentim për të mos shkaktuar faul, në mënyrë që të iu shmangen ndërprerjeve në lojë
- Pengimi i lëvizjeve të sulmit, ndoshta duke i shfrytëzuar dy mbrojtës
- Lëvizjet përpara për t'i bllokuar rrugët pasimit
- Lëvizja e mbrojtësve para duke e detyruar sulmuesin të luaj ma mbrapa në fushë
- Detyrimi i sulmuesit ta pasoj topin në një pozitë të parrezikshme

Udhëzimi 5

Gjuajtja Nisëse (10:3)

Në përputhje me parimin e rregullës 10:3, gjyqtarët duhet t'i shtyjnë skuadrat që sa më parë të ekzekutojnë gjuajtjen nisëse. Kjo do të thotë se gjyqtarët nuk duhet të jenë së tepërmi pedantë dhe të mos kërkojnë mundësinë që ta kthejnë prapa apo ta ndëshkojnë skuadrën e cila tenton ta ekzekutojë shpejt gjuajtjen nisëse.

Për shembull, gjyqtarët duhet të shmangen shënimit të rezultatit apo detyrave tjera me të cilat ndikojnë në gatishmërinë e tyre për të kontrollimin e shpejtë të pozitave të lojtarëve. Gjyqtari i fushës duhet të jetë i gatshëm të fishkëllej në momentin e duhur kur ekzekutuesi ta arrijë në pozitën e duhur, duke aluduar nga ajo që nuk ka nevojë për korrigjimin e pozitave të lojtarëve tjerë. Gjyqtari gjithashtu duhet ta ketë parasysh që bashkëlojtarët janë të lejuar ta kalojnë vijën e mesit të fushës menjëherë pas fishkëllimit. (Kjo është një përjashtim nga parimi bazë për ekzekutimin e gjuajtjeve tjera formale).

Edhe pse rregullat thonë që ekzekutuesi duhet ta shkel vijën e mesit të fushës dhe me tolerancë anësore 1.5 metra nga qendra, gjyqtarët nuk do të duhej të insistojnë së tepërmi në atë dhe të kujdesen për çdo centimetër. Gjëja kryesore është që të shmangen padrejtësi dhe paqartësi për kundërshtarin në lidhje me atë se kur dhe ku duhet të bëhet ekzekutimi i gjuajtjes nisëse.

Për më tepër, shumica e fushave nuk e kanë pikën e qendrës së fushës të shënuar, dhe disa fusha mundë edhe ta kenë të mbuluar qendrën e fushës me reklama. Në këto raste, që të dytë ekzekutuesi edhe gjyqtari padysim se duhet ta vlerësojnë pozicionin e saktë, dhe çdo insistim për saktësinë e pozitës do të jetë joreale dhe e papërshtatshme.

Udhëzimi 6

Përcaktimi i Pozitës së Qartë për Shënim

Qëllimi i Rregullës 14:1, situata e qartë për shënim ekziston kur:

- a) lojtari ka topin dhe kontrollin e trupit të vijës hapësirës së portierit kundërshtarë dhe ka mundësi të gjuaj në portë, dhe asnjë nga lojtarët kundërshtarë nuk janë në gjendje që me metoda të lejuara ta parandalojnë gjuajtjen e tij.;

kjo aplikohet edhe në rastet kur lojtari nuk e ka posedimin e topit por është gati dhe në gjendje që menjëherë ta pranojë topin; nuk duhet të ketë kundërshtarë në pozitë që ta parandalojë atë me metoda të lejuara për ta pranuar topin;

- b) Lojtari ka kontrollin e topit dhe trupit dhe vrapon (ose driblon) në kundërsulm i vetëm në drejtim të portierit kundërshtarë, dhe asnjëri nga lojtarët kundërshtarë nuk ka mundësi të i vihet përballë dhe ta parandalojë kundërsulmin;

kjo aplikohet edhe në rastet kur lojtari nuk e ka posedimin e topit por është gati dhe në gjendje që menjëherë ta pranojë topin; dhe portieri kundërshtar shkakton përplasje si në Rregullën 8:5 Shpjegimi, parandalon pranimin e topit; në këtë rast të veçantë, pozita e lojtarëve mbrojtës është e parëndësishme;

- c) portieri lëshon hapësirën e portës dhe kundërshtari ka kontroll të plotë të topit dhe trupit dhe i papenguar ka mundësi të qartë për të gjuajtur në portën e zbrazët.

Udhëzimi 7

Ndërprerjet e Lojës nga Kohëmatësi dhe Delegati (18:1)

Nëse kohëmatësi apo delegati intervenon kur loja është veçse e ndërprerë, loja do të rifilloj me gjuajtje e cila korrespondon me arsyen e ndërprerjes.

Nëse kohëmatësi apo delegati intervenon, dhe në këtë mënyrë ndërpritet loja në momentin kur topi është në lojë, më ç' rast aplikohen rregullat e mëposhtme:

A Ndërrim i gabuar ose hyrje e palejuar në fushë nga lojtari (Rregulla 4:2-3, 5-6)

Kohëmatësi (ose delegati) duhet ta ndërprejë lojën menjëherë, pa e respektuar "përparësinë" koncept në rregullën 13:2 dhe 14:2. Nëse për shkak të ndërprerjes së këtillë, për shkak të shkeljeve nda ekipi mbrojtës, është prishur situata e qartë për shënim, duhet gjykuar 7-metërs në përputhje me Rregullën 14:1a. Në të gjitha rastet tjera loja rifillon me gjuajtje të lirë.

Lojtari fajtor duhet të ndëshkohet në përputhje me Rregullën 16:3a. Megjithatë, në rast të futjes së palejuar në fushë sipas Rregullës 4:6 gjatë situatës së qartë për shënim, atëherë ky lojtarë ndëshkohet në përputhje me Rregullën 16:6b në ndërthurje me Rregullën 8:10b.

B Nërprerjet për arsye tjera, p.sh. sjelljet josportive në zonën e zëvendësimeve

a) Ndërprerja nga kohëmatësi

Kohëmatësi duhet të pres deri te ndërprerja e radhës në lojë dhe pastaj t'i informoj gjyqtarët.

Nëse megjithatë kohëmatësi e ndërprejë ndeshjen për deri sa topi gjendet në lojë, atëherë loja rifillon me gjuajtje të lirë për skuadrën e cila ishte në posedim të topit në kohen e ndërprerjes. Nëse loja ndërpritet për shkak të shkeljeve të bëra nga ekipi mbrojtës me këtë rast prishet situata e qartë për shënim, pastaj duhet të gjykohet 7-metërs në përputhshmëri me Rregullën 14:1b.

(e njëjta aplikohet edhe në raste kur kohëmatësi e ndërpre në ndeshjen për shkak të kërkesës së njëres skuadër për time-out ekiporë, edhe e njëjta refuzohet nga gjyqtarët për shkak se nuk është koha e duhur. Nëse është prishur situata e qartë për shënim për shkak të ndërprerjes, për këtë duhet të gjykohet 7-metërsh).

Kohëmatësi nuk ka të drejtë të shqiptoj ndëshkim për lojtarin edhe apo përfaqësuesin zyrtarë të skuadrës. Të njëjtën gjë e bëjnë edhe gjyqtarët, nëse ata personalisht nuk e kanë parë shkeljen e Rregullave. Ata mundë vetëm të japin paralajmërim joformal. Nëse shkelja është sipas Rregullës 8:6 ose 8:10, ata duhet të paraqesin raport me shkrim.

b) Ndërprerja e ndeshjes nga delegati

Delegati i IHF, apo i federatës kontinentale apo kombëtare, i cili është i deleguar në ndeshje, ka të drejtë të informoj gjyqtarët mbi vendimet e mundshme në rast të shkeljes së Rregullave (përjashtim bënë vendimi i marrë i gjyqtarëve bazuar në faktet e vëzhguara) ose në lidhje me shkeljet e rregullave të zonës së zëvendësimeve.

Delegati mundë ta ndërpres menjëherë ndeshjen. Në këtë rast loja rifillon me gjuajtje të lirë për skuadrën e cila nuk bërë shkelje të rregullave për çka është ndërprerë ndeshja.

Nëse ndërprerja është bërë si pasojë e shkeljeve të rregullave nga skuadra mbrojtëse, dhe ndërprerja ka shkakuar prishjen e situatës së qartë për shënim, pastaj duhet të gjykohet 7-metërsh në përputhje me Rregullën 14:1a.

Gjyqtarët janë të obliguar të tregojnë ndëshkim personal progresiv në përputhje me udhëzimet e delegatit.

Faktet që kanë të bëjnë me shkeljen e Rregullës 8:6 dhe 8:10 duhet të paraqiten në raport me shkrim.

**RREGULLORJA
E ZONËS
SË ZËVENDËSIMEVE**

1. Zonat e zëvendësimeve janë të vendosura jashtë vijave anësore në anën e djathtë dhe të majtë nga vija e mesit të fushës deri në përfundimin e bankës së rezervistëve të skuadrës gjegjëse (krahësuar me numrin e rrethave të ulësive, e cila gjithashtu është e lejuar), edhe gjithashtu nëse mbrapa tyre gjendet hapësirë (Rregullat e lojës, Diagrami 1).

Rregullorja për ngjarje/gara të IHF-it edhe atyre kontinentale përshkruhet se banka rezervë, dhe në këtë mënyrë zona përkatëse e trajnerëve, duhet të fillojë në distancë prej 3.5 metrave nga vija e mesit të fushës. Kjo gjithashtu aplikohet te garat e të gjitha niveleve.

Asnjë objekt i cfarëdo forme nuk guxon të vendoset në mes të vijës anësore dhe bankës së rezervistëve të skuadrës (për së paku 8 metra nga vija e mesit të fushës).

2. Vetëm dhe zyrtarët e skuadrës të cilët janë të shënuar në procesverbalin e ndeshjes janë të lejuar të qëndrojnë në zonën e zëvendësimeve (4:1-2).

Nëse ka nevojë për ndonjë përkthyes, ai duhet të qëndrojë mbrapa zonës së zëvendësimeve.

3. Zyrtari i skuadrës i cili qëndron në zonën e zëvendësimeve duhet të ketë të veshur veshje sportive ose veshje civile. Ngjyrat të cilat mundë të shkaktojnë ngatërrim me lojtarët në fushë nuk janë të lejuara.

4. Kohëmatësi dhe procesmbajtësi duhet ta mbështesin dhe ndihmojnë gjyqtarët në lidhje me vëzhgimin dhe mbajtjen gjendje të rregullt zonën për zëvendësime para dhe pas ndeshjes.

Nëse para ndeshjes ka ndonjë shkelje të Rregullave në lidhje me zonën e zëvendësimeve, loja nuk duhet të fillojë para se të rregullohet shkelja e Rregullave. Nëse këto shkelje janë bërë gjatë ndeshjes, ndeshja nuk duhet të vazhdojë pas ndërprerjes së radhës për deri sa çështja të mos zgjidhet.

5. Personat zyrtarë të skuadrës kanë të drejtë dhe detyrë që ta udhëheqin dhe ta menaxhojnë skuadrën e tyre gjithashtu gjatë ndeshjes, në frymë të korrektësisë dhe sportit dhe në korniza të rregullave të lojës. Në parim, ata duhet të ulen në bankën e skuadrës.

Megjithatë, zyrtarëve të ekipit **ju lejohe**t të sillen (lëvizin) brenda "zonës së trajnerëve". 'Zona e trajnerëve' është hapësira drejt me bankën e rezervistëve dhe nëse kjo është e mundur drejt me bankën prapa saj.

Lëvizjet dhe pozicionimi në 'zonën e trajnerëve' lejohen për qëllime të dhënies së udhëzimeve taktike dhe për dhënien e kujdesit mjekësorë. Në parim, në të njëjtën kohë vetëm njëri nga lojtarët ka të drejtë të qëndroj në këmbë dhe të lëvizë.

Kjo është, natyrisht, e lejuar që njëri nga zyrtarët e ekipit të largohet nga 'zona e trajnerëve' kur ai menjëherë do ta paraqet "kartučin e gjelbër" për të kërkuar time-out ekipor. Megjithatë zyrtarit të skuadrës nuk i lejohe

ta lëshoj 'zonën e trajnerëve' dhe të qëndroj me 'kartuç të gjelbër' para tavolinës zyrtare duke pritur momentin për të kërkuar time-out ekipor.

"Përfaqësuesi zyrtarë i skuadrës" mundet gjithashtu ta lëshoj 'zonën e trajnerëve' në raste të veçanta, për shembull, për kontakt të domosdoshëm me kohëmatësin dhe procesmbajtësin.

Në parim, lojtarët në zonën e zëvendësimeve duhet të ulen në bankën e zëvendësuesve.

Lojtarëve megjithatë **u lejohe**t:

- të lëvizin mbrapa bankës së rezervistëve për t'u ngrohur (përgatitur për lojë), pa top, me kusht që të këtë hapësirë të mjaftueshme dhe që nuk pengon.

Zyrtarëve të skuadrës ose lojtarëve **nuk u lejohet** të:

- pengoj me këtë ose ofendoj gjyqtarët, delegatin, kohëmatësin/procesmbajtësin, lojtarin, zyrtarin e skuadrës, shikuesit, duke u sjellur në mënyrë provokuese, protestuese, ose në mënyrë tjetër josportive më anë të (fjalëve, shprehjes së fytyrës apo gjesteve);
- lëshon zonën e zëvendësimeve me qëllim që të ndikoj në lojë;

Zyrtari i skuadrës dhe lojtari në përgjithësi pritet të qëndrojnë në zonën e zëvendësimeve të skuadrës së tyre. Nëse zyrtari i skuadrës megjithatë largohet nga zona e zëvendësimeve për një vend tjetër, ai e humbe të drejtën për ta drejtuar dhe menaxhuar skuadrën e tij dhe duhet të kthehet në zonën e zëvendësimeve për rifituar drejtat e tij.

Në përgjithësi, lojtarët edhe zyrtarët e skuadrës mbetin nën juridiksionin e gjyqtarëve gjatë gjithë ndeshjes, dhe Rregullat normale për ndëshkimet personale progresive aplikohen gjithashtu nëse lojtari apo zyrtari i skuadrës largohet nga fusha apo zona e zëvendësimeve. Prandaj, sjellja josportive, serioze josportive dhe ekstreme josportive duhet të ndëshkohet sikurse ndëshkimet në fushën e lojës ose në zonën e zëvendësimeve.

6. Nëse është shkelur rregullorja e zonës së zëvendësimeve, gjyqtarët janë të obliguar të veprojnë në bazë të Rregullës 16:1b, 16:3d ose 16:6b (vërejtje, përjashtim, shkualifikim).

Udhëzime për Fushën e Lojës dhe Portat

- a) Fusha është kënddrejtë me dimensione 40X 20 metra. Vërtetohet me matjen e gjatësisë të dy diagonaleve. Nga ana e jashtme e një këndi deri te ana e jashtme të këndit të kundërt, diagonalja duhet të jetë me gjatësi 44,72 metra. Gjatësia e diagonales për gjysmën e fushës është 28,28 m, e matet nga ana e jashtme e çdo këndi të gjysmës së fushës të gjysmës tjetër. Fushën e përcaktojnë shenjat e dukshme të cilat quhen "vijat". Gjerësia e linjës së portës (ndërmjet shtyllave) është 8 cm, ndërsa të gjitha vijat tjera janë të gjëra 5 cm. Vijat të cilat ndajnë gjysmë fushat mund të jenë me ngjyrat të ndryshme;
- b) Hapësira e portierit para portës është prej katërkëndëshit me madhësi 3x6m dhe dy të katërta të rrethit të cilat vazhdojnë anët e katërkëndëshit nga çdo anë, çdo njëri me rreze prej 6m. E vizatojmë ashtu që paralel me vijën e portës në largësi prej 6 m nga ana e prapme të vijës së golit tërheqim vijë të gjatë 3 m. Nga fundi i çdo vije vazhdon nga një e katërta e harkut të rrethit me rreze 6m me qendër në këndin e brendshëm të anës së prapme të shtyllës përkatëse. Vijat dhe këndet të cilat i përkasin hapësirës të portierit quhen vijat e hapësirës së portierit. Largësia ndërmjet pikave të jashtme të pikave të bashkimit të harqeve të rrethit dhe vijave jashtë portës është 15m.
- c) Vija e ndërprerë e gjuajtjes të lirë (vija e 9m) bëhet paralel dhe në mënyrë koncentrike me vijën e hapësirës së portierit në largësi prej 3m prej saj. Segmenti i shënuar si pjesë ndërmjet tyre është i gjatë 15 cm. Segmentet ndahen nën këndin e drejtë përkundër rrezes përkatëse. Matja e segmenteve të lakuara bëhet më vijën e jashtme.
- d) Vija e 7 m është me gjatësi 1m, shënohet para portës, paralel me vijën e portës në largësi prej 7 m nga vija e prapme e portës deri te vija e përparme e vijës së 7 m.
- e) Vija kufitare e portierit (vija e 4 m) gjendet para portës dhe është e gjatë 15 cm. Është paralel me vijën e portës dhe 4m larg prej saj kur matet nga fundi i prapmë i vijës së portës derite fundi i përparmë të vijës së 4m, çka do të thotë se gjerësia e të dy vijave është e kështu në dimensionet.

f) Fusha duhet të rrethohet nga një shirit sigurues të gjerësisë së paku 1m përgjatë vijës së gjatë dhe 2m prapa vijës së jashtme të golit.

g) Portat (fotografia 2) janë të vendosura në mes të çdo vije të portës. Portat duhen të jenë të përforcuara për dysHEME ose për muret prapa tyre. Lartësia e brendshme e tyre është 2m, e gjerësia 3m. Korniza e portës duhet të jetë katërkëndëshe, çka do të thotë se diagonalja e brendshme është 360,5 (max. 361 - min. 360 cm, ndryshimi në diagonale të portës së njëjtë mund të jetë më së shumti 0,5 cm). Ana e jashtme e kornizës të portës duhet të jetë në vijë me fundin e prapmë të vijës së portës (dhe vijës jashtë portës) çka do të thotë se ana e përparme e kornizës së portës gjendet 3 cm përpara vijës së jashtme të portës. Shtyllat dhe horizontalja e cila i lidhë duhet të jenë nga materiali i njëjtë, të formës katrore, me gjerësi 8 cm, me qoshet të rumbullakuara me rreze 4 +/- 1mm. Nga tre anë të dukshme të fushës shtyllat dhe horizontalja duhen të jenë të ngjyrosur me dy ngjyra kontraste të cilat dallohen qartë edhe nga prapavija; të dy portat në fushë duhen të jenë me ngjyrë të njëjtë;

Fushat të ngjyrosura të portës matur nga bashkimi i shtyllës dhe horizontales janë me dimension prej 28 cm në të dy drejtime. Të gjitha fushat tjera janë të gjata 20 cm. Në portë duhet të jetë rrjeta e cila është e përforcuar ashtu që topi i futur në portë nuk mund të s'prapëset menjëherë ose të kaloj nëpër atë. Nëse është e nevojshme mund të përdoret edhe rrjeta shtesë e vendosur brenda portës pas vijës së portës. Largësia nga vija e portës edhe të kësaj rrjete shtesë duhet të jetë rreth 70 cm, por nuk guxon të jetë më pak se 60 cm;

h) Thellësia e rrjetës duhet të jetë në maje 0,9 m, ndërsa poshtë 1,1 m prej vijës së portës, me tolerancë prej +/- 0,1 m. Madhësia e hapjes të rrjetës nuk guxon të jetë më e madhe se 10x10 cm. Rrjeta duhet të jetë e përforcuar për shtyllat dhe horizontalen së paku çdo 20 cm. Është e lejuar lidhja e rrjetës shtesë ashtu që topi mos të kaloj ndërmjet tyre;

